



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË  
ARSIMIN E LARTË**

**Raport i Akreditimit Institucional të  
Universitetit të Shkodrës, “Luigj Gurakuqi”**

**Dhjetor 2019**

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:**

- |    |                           |          |
|----|---------------------------|----------|
| 1. | Prof. As. Ana Kapaj       | Kryetare |
| 2. | Prof. As. Arben Mehmeti   | Anëtar   |
| 3. | Prof. As. Florim Grajcevc | Anëtar   |

## **Përmbajtja**

Tabela e përmbajtjes

<b>Rreth këtij vlerësimi</b> .....	<b>4</b>
<b>Raporti përmbledhës</b> .....	<b>7</b>
<b>Përmbledhja e gjetjeve</b> .....	<b>9</b>
<b>Rekomandime</b> .....	<b>9</b>
<b>Pohimi i veprimeve të ndërmarra</b> .....	<b>10</b>
<b>Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi</b> .....	<b>10</b>
<b>Raport i detajuar</b> .....	<b>11</b>
<b>Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij</b> .....	<b>11</b>
<b>Gjetjet</b> .....	<b>14</b>
<b>Rekomandime</b> .....	<b>14</b>
<b>Pohimi i veprimeve të ndërmarra</b> .....	<b>14</b>
<b>Gjykimi</b> .....	<b>15</b>

## **Rreth këtij vlerësimi**

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle Universiteti i Shkodrës, “Luigj Gurakuqi” i përmbush Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve të arsimit të lartë dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga ASCAL-i. Grupi i vlerësimit të jashtëm drejtohet nga një eksperte shqiptare e arsimit të lartë, me një përvojë të gjerë në këtë fushë.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga Universiteti i Shkodrës, por edhe për t’iu ofruar palëve të interesit, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të i përmbushin standardet. Krahas kësaj, ky raport i ndihmon IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatohet për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Në këtë raport identifikohen karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër të ndërmarra, dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit dhe ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL-i i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t’i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe duke përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

## Historik i Universitetit të Shkodrës

Universiteti i Shkodrës, “Luigj Gurakuqi”, një institucion publik i arsimit të lartë, zë fill me Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, i cili u hap më 2 shtator 1957, si Instituti i parë në Shqipërinë e Veriut që ofronte studime të larta, dhe i dyti në vend pas Universitetit të Tiranës. Ky institut konsiderohej si një prej institucioneve më të rëndësishme në vend, dhe qendra më e madhe e mësimdhënies në Shqipërinë e Veriut.

Gjatë rrugëtimit të tij, Universiteti i Shkodrës ka kaluar ndryshime të rëndësishme në strukturë, përmbajtje, organizim dhe në drejtimin e tij. Mund të veçohen dy periudha të mëdha të zhvillimit të tij:

Periudha e parë, 1957 – 1990, kur funksionon si Institut i Lartë Pedagogjik, me afat studimi 2-vjeçar e më pas 3 dhe 4-vjeçar.

Periudha e dytë, 1991 e në vazhdim, kur Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, fiton statusin e plotë universitar, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës e fitoi statusin ligjor universitar më 28.05.1991, të cilin e gëzon edhe tani. Në kuadër të ndryshimit të statusit nga Institut në Universitet, USH-ja filloi rindërtimin e degëve ekzistuese dhe hapjen e fakulteteve dhe degëve të reja. Krahas Fakultetit të Shkencave të Natyrës, fakultetet e reja ishin si vijon: Fakulteti i Ciklit të Ulët në vitin 1991, Fakulteti i Shkencave Shoqërore në vitin 1991, Fakulteti Ekonomik në vitin 1996, Fakulteti i Drejtësisë në vitin 1996, dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në vitin 2001. Sot, USH-ja është një nga universitetet publike në vend që ndiqet prej studentëve nga veriu i Shqipërisë, si dhe trojet shqiptare, si Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia.

Aktualisht në USH ofrohet 3 cikle studimi: cikli i parë ku jepet diploma “Bachelor”, cikli i dytë ku studentët diplomohen në “Master të Shkencave” ose “Master Profesional”, si dhe cikli i tretë, që përfshin PhD-në. Në Universitetin e Shkodrës mundësohen 61 programe studimi në tri ciklet e studimit:

1. Cikli i parë – Bachelor (26 programe studimi)
2. Cikli i dytë – Master i Shkencave (14 programe studimi) dhe Master Profesional (20 programe studimi)
3. Cikli i tretë – PhD (1 program studimi)

Universiteti i Shkodrës ka 6 fakultete, të cilat përmbliidhen si vijon:

**Fakulteti i Shkencave të Natyrës**, i cili nisi veprimtarinë e tij arsimore dhe shkencore me themelimin e Institutit të Lartë Pedagogjik, më 2 shtator 1957. Aktualisht, Fakulteti ka 4 departamente dhe një qendër kërkimore, përkatësisht departamenti i Biologji-Kimisë, departamenti i Fizikës, departamenti i Infermierisë, dhe Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës.

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit** i ka fillesat në vitin akademik 1981-1982, me hapjen e programit të studimit për Mësuesit e klasave I-IV në shkollat 8-vjeçare (Cikli i Ulët). Ky fakultet organizohet në 4 njësi bazë: Departamenti i Mësuesisë, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale, Departamenti i Edukimit fizik e i Sporteve dhe Departamenti i Arteve.

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore** është një prej themelvënësve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe e ka gjenezën e tij që në vitin 1957, vit kur u hap për herë të parë Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës. Aktualisht, ky fakultet organizohet në 4 njësi bazë: Departamenti i Gjuhës shqipe, Departamenti i Letërsisë, Departamenti i Historisë dhe Departamenti i Gjeografisë.

Studimet e larta në drejtësi në Universitetin e Shkodrës u hapën me VKM Nr. 349, datë 10.08.1992 “Për hapjen e degës së Drejtësisë dhe Administrim-Biznesit në Universitetin e Shkodrës”, ndërsa **Fakulteti i Drejtësisë** u hap në vitin 1996, ku ofrohej një program studimi 4-vjeçar. Aktualisht ky fakultet organizohet në tri departamente: Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane.

Për një periudhë disavjeçare pranë Institutit të Lartë Pedagogjik në Shkodër ka funksionuar Filiali i **Fakultetit të Ekonomisë** së Universitetit të Tiranës. Në shtator 1992 u hap dega e Administrim-Biznesit në USH. Në vitin 1996, Fakulteti Ekonomik u hap krahas Fakultetit të Drejtësisë. FE-ja ka tri departamente, përkatësisht Departamenti i Administrim - Biznesit (njëkohësisht edhe departamenti më i vjetër i fakultetit), Departamenti i Financë - Kontabilitetit, dhe Departamenti i Turizmit.

**Fakulteti i Gjuhëve të Huaja** e ka fillesën me hapjen e katedrës së gjuhëve të huaja në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, që mbulonte mësimdhënien e gjuhës ruse dhe frënge. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja përbëhet nga tri departamente: Departamenti i Anglistikës, Departamenti i Gjermanistikës, Departamenti i Romanistikës.

Mbështetur në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, Universiteti i Shkodrës e ka kryer procesin e akreditimit institucional në vitin 2017. Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 70, datë 21.09.2017, Universitetit të Shkodrës iu dha akreditimi për një periudhë kohore 2 (dy) vjeçare. Ky është procesi i parë i akreditimit periodik për Universitetin e Shkodrës.

## Raporti përmbledhës

Grupi i vetëvlerësimit i Universitetit të Shkodrës ka përgatitur raportin e vetëvlerësimit. Ky grup përfshinte personelin e nivelit të lartë, stafin akademik dhe personelin administrativ, dhe një përfaqësues të studentëve. Projekt-raportet e vetëvlerësimit (RVV) u qarkulluan në Universitet për përfitim të komenteve, si dhe u finalizuan dhe u miratuan nga Rektori dhe Senati. Ky është procesi i parë i akreditimit periodik për Universitetin e Shkodrës (USH). Në vitin 2017, ky Universitet përfundoi procesin e parë të akreditimit dhe me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 70, datë 21.09.2017, Universitetit të Shkodrës iu dha akreditimi për një periudhë kohore 2 (dy) vjeçare.

Në RVV u prezantuan veprimtaritë e Universitetit. RVV-ja mbështetej në evidenca, ndërsa përpara dhe gjatë vlerësimit u përforcua me më shumë evidenca të hollësishme. Evidencat u ofruan si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë shqipe. Në përgjithësi, RVV-ja e ndihmoi Grupin e Vlerësimit të Jashtëm dhe mbi të grupi mbështeti vlerësimin që kreu.

Vizita e vlerësimit u krye gjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Kosova, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga stafi i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit i siguruar nga ASCAL-i, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me evidenca mbështetëse, disa javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Gjithsej, u morën në konsideratë 300 dokumente, të cilat e ndihmuan grupin e vlerësimit të njëjti me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit, godinat dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Dokumentet që u shqyrtuan përfshinin Statutin e Universitetit, Rregulloret Akadematike, Raportet Vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, gamën e marrëveshjeve të jashtme, shembuj të informacionit mbi programin dhe dokumentacione të mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit, u organizuan një sërë takimesh, që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të kuptonte më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektoren, drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, stafin akademik, personelin mbështetës dhe administrativ, alumnit dhe përfaqësuesit e organizatave vendore dhe partnere. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e vizitave të Universitetit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekat, sallat e kompjuterëve, laboratorët, hapësirat e mësimdhënies dhe mjediset administrative, si dhe godinën e re të Fakultetit Ekonomik. Pas vlerësimit të të gjitha dokumenteve

të vëna në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e renditura në vijim.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Organizimi i Universitetit përcaktohet në Statutin dhe në Rregulloret e tij, dhe në mbledhjet zyrtare ndiqen procedura dhe protokolle të vendosura. Universiteti po ecën mirë me përmbushjen e kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se USH-ja ka marrë masa për të lidhur bashkëpunim të shëndoshë me institucionet publike dhe private për mbështetjen e studentëve gjatë trajnimit praktik dhe punësimit të tyre në të ardhmen. Krahas kësaj, ky Grup rekomandon që USH-ja duhet të gjejë një mënyrë më të mirë për të komunikuar në nivelin lart-poshtë të drejtimit dhe anasjelltas. Krahas kësaj, USH-ja duhet të gjejë një mënyrë për të krijuar autonomi financiare në njësinë bazë.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Burimet. Përgjegjësitë për burimet janë qartësisht të përcaktuara në Statutin dhe në Rregulloret e Universitetit dhe ato përmbushen në mënyrë të përshtatshme nga Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmoi se Universiteti ka sisteme dhe procese përgjithësisht të përshtatshme dhe të efektshme për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe fizike. Megjithatë, Grupi identifikoi një dobësi që disa nga anëtarët e stafit mësimdhënës nuk i përmbushin kriteret teknike për ofrimin e shërbimeve teknike të përshtatshme.

Universiteti i Shkodrës i përmbush kryesisht standardet për Kurrikulën. Programet ofrohen në tri cikle studimi dhe pasqyrojnë misionin dhe pozicionin e Universitetit në rajonin vendor dhe tregun e punës. Programet e studimit janë të përcaktuara qartë, ndërsa studentët marrin informacione të përshtatshme dhe në kohën e duhur. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron dobësi faktin që disa programe në psikologji nuk i përmbushin kërkesat e standardeve në lidhje me raportin e stafit akademik me kohë të plotë me atë me kohë të pjesshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, si dhe nuk bëri asnjë pohim.

Universiteti i Shkodrës i përmbush kryesisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Universiteti ka një axhendë të zhvilluar për kërkimin. Universiteti menaxhohet në mënyrë të rregullt. Universiteti e përmirëson vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies, duke përfshirë stafin e ri dhe me përvojë, përmes Qendrës së Ekselencës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Universiteti ofron udhëzim, këshillim, tutorim dhe mbështetje të formave të ndryshme për studentët e ardhshëm dhe ata aktualë, dhe aty ku është e mundur, edhe për studentët me nevoja shtesë ose ata që u përkasin minoriteteve të pafavorizuara. Studentët kanë në dispozicion një bibliotekë mjaft të pasur. Grupi i



Vlerësimi të Jashtëm pohoi se Universiteti po ndërmer veprime për përgatitjen e rregullores së Alumnit dhe për përmirësimin e bazës së të dhënave për alumnit nga zyra e Këshillimit të Karrierës, për rritjen e performancës së zyrës së Këshillimit të Karrierës, si dhe për forcimin e efektshmërisë së rrjetit të tutorimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi ndonjë dobësi, si dhe nuk dha rekomandime.

## **Përmbledhja e gjetjeve**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë

### **Dobësitë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Konstatohen disa probleme me kanalet e informacionit midis strukturave të Universitetit të Shkodrës. **Kapitulli III, Standardi I.2**
- Në nivel Departamenti nuk ka autonomi financiare. **Kapitulli III, Standardi I.4**
- Disa nga zyrat e stafit mësimdhënës nuk i përmbushin kriteret teknike për shërbime teknike të përshtatshme **Kapitulli III, Standardi V.1**
- Disa nga programet e Bachelor-it të Shkencave në psikologji nuk i përmbushin kërkesat e standardeve në lidhje me raportin e stafit akademik me kohë të plotë me atë me kohë të pjesëshme, që është 70/30%. **Kapitulli I, Standardi I.8, Kapitulli I, Standardi I.9**
- Ndonëse është konfirmuar alokimi i fondeve të buxhetit për kërkimin, nuk janë gjetur ende mënyrat e përshtatshme për t'i alokuar këto fonde. **Kapitulli II, Standardi I.1**

## **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Informacioni duhet të qarkullojë më mirë nga nivelet e larta të menaxhimit në ato më të ulëtat dhe anasjelltas. **Kapitulli III, Standardi I.2**
- Universiteti i Shkodrës duhet të gjejë një mënyrë për të krijuar autonomi financiare në njësinë bazë. **Kapitulli III, Standardi I.4**
- Zyrat ekzistuese të stafit mësimdhënës duhet të riorganizohen në një mënyrë që rrit standardet teknike për hapësirat e punës dhe ofrohet ndriçim natyral **Kapitulli III, Standardi V.1**
- Duhet të përmbushet kushti i stafit akademik të brendshëm me kohë të plotë, që mbulon 70% të ngarkesës mësimore të programeve të studimit. **Kapitulli I, Standardi I.8, Kapitulli I, Standardi I.9**

- Universiteti duhet të gjejë mënyra më të mira për ta alokuar fondin për kërkimin. **Kapitulli II, Standardi I.1**

## **Pohimi i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- Universiteti i Shkodrës ka marrë masa për të lidhur bashkëpunim të shëndoshë me institucionet publike dhe private për mbështetjen e studentëve gjatë trajnimit praktik dhe punësimit të tyre në të ardhmen. **Kapitulli III, Standardi III.3**
- Universiteti i Shkodrës ka marrë masa për të përmirësuar hapësirat në dispozicion të stafit dhe studentëve **Kapitulli III, Standardi V.1**
- Zyrat e Këshillimit të Karrierës po e rrit performancën dhe USH-ja po përpiqet të forcojë rrjetin e tutorimit për të rritur efektshmërinë **Kapitulli I, Standardi III.1**
- Përgatitja e rregullores së Alumnit dhe përmirësimi i bazës së të dhënave për alumnit nga Zyra e Këshillimit të Karrierës **Kapitulli I, Standardi III.9**
- Universiteti e përmirëson vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies, duke përfshirë stafin e ri dhe me përvojë, përmes Qendrës së Ekselencës. **Kapitulli I, Standardi II.4; Kapitulli III, Standardi IV.2**
- Institucioni po përpiqet të forcojë bashkëpunimin shkencor midis Qendrave Kërkimore dhe Departamenteve. **Kapitulli II, Standardi I.2**

## **Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi**

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht**

## **Gjykim i përmbledhur**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Bordit të Akreditimit se në Universitetit të Shkodrës, “Luigj Gurakuqi”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

## Raport i detajuar

### Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti i Shkodrës e kryen veprimtarinë akademike dhe shkencore mbështetur në aktet ligjore në forcë, statutin e tij, si dhe akte të tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet e tij qeverisëse. Është një institucion i lartë publik dhe është themeluar më 28.05.1991. **[B1.1]**. Statuti është dokumenti themelor që përcakton normat dhe rregullat bazë të funksionimit dhe veprimtarive të USH-së, në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat e saj. Statuti është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 33. Veprimtaritë e përditshme të USH-së zhvillohen në përputhje me Rregulloren e tij **[B1.1, A1.1]**, që bazohen në Vendimin e Senatit për Statutin e Senatit, Nr. Prot. 690, Nr. 116, datë 18.05.2010. Statusi i USH-së përditësohet dhe miratohet me Vendim të Senatit Nr. Prot. 725, datë 02.03.2018. Ky dokument rregullon mësimdhënien dhe veprimtaritë shkencore dhe administrative të Universitetit, në përputhje me misionin dhe objektivat e tij, si dhe i shtrin efektet rregulluese në të gjitha strukturat qeverisëse. **[M1, RVV f. 16] Kapitulli III, Standardi I.1**
- 1.2 Organizimi dhe menaxhimi i USH-së garantohen nga organet kolegjiale dhe kryhen në përputhje me kuadrin ligjor në forcë. Organet vendimmarrëse më të larta janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, dhe bëjnë të mundur administrimin e veprimtarive akademike dhe financiare të universitetit. **[A1.20, A2.3, B1.2, B1.3, B1.4]** Strukturat e tjera kolegjiale, dhe autoritetet qeverisëse akademike dhe administrative veprojnë në Universitet, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Senati Akademik, si organi vendimmarrës kolegjial më i lartë, vendos mbi planifikimin strategjik më të rëndësishëm të institucionit në fushat e mësimdhënies, kërkimit shkencor, dhe jep miratimin për çështjet administrative dhe financiare. Ky organ funksionon sipas Statutit të USH-së, që parashikon të gjitha kompetencat e tij **[B1.1]**. Organi mblidhet në mënyrë periodike dhe jep vendimet përkatëse. Bordi i Administrimit, si organ vendimmarrës kolegjial **[B1.2, B1.3, B1.4]** mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e universitetit, në lidhje me menaxhimin administrativ, financiar dhe të aseteve të institucionit. Bordi i Administrimit funksionon në bazë të Rregullosës së tij, mblidhet në mënyrë periodike, dhe jep vendimet përkatëse **[B1.2]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mendon se këto **struktura duhet të bashkërendohen më mirë me njëra-tjera dhe brenda tyre**. Gjatë mbledhjeve me Senatin u vërejt se mungonte qarkullimi i informacionit ndërmjet tyre **[M2]. Kapitulli III, Standardi I.2**
- 1.3 Organet kolegjiale të USH-së mblidhen në mënyrë periodike, në përputhje me dispozitat e rregulloreve specifike për funksionimin e tyre. Senati, si organi kolegjial akademik më i lartë i Universitetit, i kryen veprimtaritë e tij në mbledhje të rregullta **[C2, M2]**. Senati Akademik i kryen funksionet e tij në bashkëpunim me organe kolegjiale të tjera të USH-së. Bashkëpunon me Bordin e Administrimit dhe organe kolegjiale të tjera për miratimin e statutit dhe rregullosës së Universitetit, planifikimin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë për

zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, buxhetin e USH-së, etj. Krahas kësaj, Bordi i Administrimit, si organi kolegjal përgjegjës për administrimin financiar të institucionit, bashkëpunon me Senatin Akademik për hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm, mbështetur në propozimet e njësive kryesore dhe atyre bazë, planin strategjik të zhvillimit institucional, dhe programin e buxhetit afatmesëm [B2.14, B3.10, B3.11, B3.12]. Gjatë vizitës në HEI, u planifikua një mbledhje me Bordin e Administrimit, ndonëse nuk është zhvilluar ende, pasi anëtarët e jashtëm të bordit nuk u paraqitën. [M9] Vendimet e organeve kolegjiale (Senati Akademik, Rektorati, Bordi i Administrimit) protokollohen dhe iu kalohen strukturave përkatëse për zbatim, në përputhje me objektin e vendimit.

Departamenti është njësia bazë që mundëson dhe zhvillon diskutime konstruktive me anëtarët e stafit akademik. Mbledhjet e departamentit drejtohen nga përgjegjësi i departamentit, dhe përfshijnë adresimin e çështjeve të ndryshme, detyrave të mësimdhënies, programet e studimit, monitorimin dhe caktimin e veprimtarive të kërkimit shkencor që kryhen nga anëtarët e departamentit, si dhe trajtimin e marrëdhënies me studentët. [M3, M10].

### **Kapitulli III, Standardi I.3**

- 1.4 Universiteti i Shkodrës funksionon në përputhje me bazën ligjore në fushën e arsimit të lartë, ku gjithashtu është mbështetur për hartimin e akteve të funksionimit të brendshëm, që garantojnë autonominë e jashtme dhe të brendshme të institucionit. Autonomia e brendshme sigurohet nga Statuti dhe Rregulloret e institucionit, që përcaktojnë rregullat e organizimit dhe funksionimit të institucionit dhe vlerësimet institucionale periodike. USH-ja ka ngritur Drejtorinë e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve, dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [B1.1, B1.7, B1.8], që monitoron kufijtë e autonomisë akademike dhe administrative. Një nga mekanizmat e ngritur për të siguruar dhe për të garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që është organ kolegjal.

Megjithatë, këtij institucioni i **mungon autonomia financiare në nivel Departamenti**, që përbën një nevojë të parashikuar në Ligjin për arsimin e lartë. [M1, M9] **Kapitulli III, Standardi I.4**

- 1.5 USH-ja u angazhua për hartimin e strategjisë së re të zhvillimit institucional për periudhën 2017-2021, si përgjigje ndaj detyrimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në Strategjinë e Zhvillimit përcaktohen aspektet kryesore të institucionit, që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm, si: mësimdhënia dhe mësimnxënia, ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti, kërkimi, angazhimi social, stafi dhe infrastruktura. Masat për përmbushjen e objektivave strategjike, në përputhje me misionin, objektivat dhe platformën e zhvillimit të UT-së dhe burimet e financimit, përshkruhen në këtë dokument. [A1.18] **Kapitulli III, Standardi I.5**

- 1.6 Sipas Nenit 32, të Ligjit Nr. 80/2015, të gjitha institucionet e arsimit të lartë paraqesin, pranë ministrisë përgjegjëse, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Në raportin vjetor, që paraqitet në mënyrë periodike, vlerësohet efektshmëria e

mësimdhënies dhe kërkimit në njësitë kryesore të USH-së, në përputhje me standardet. Rektorati i USH-së e ka paraqitur Raportin Vjetor për Kërkimit Akademik dhe Shkencor dhe Veprimtaritë Financiare të Universitetit për vitin akademik 2018-2019 **[B1.11]**. Ky raport u paraqit nga Rektorati gjatë mbledhjes së Senatit Akademik dhe u bë objekt diskutimit ndërmjet stafit akademik dhe administrativ, të ftuarve dhe studentëve **[M1, M2]**. Mbështetur në gjetjet e raportit, Rektorati merr masa për përmirësimin e problemeve të ecurisë së institucionit në përgjithësi, dhe aspekte të tjera në veçanti, si dhe përcakton strukturat përgjegjëse për përmbushjen e tyre. **Kapitulli III, Standardi I.6**

1.7 Organizimi i USH-së mundëson liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe në përzgjedhjen e stafit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. USH-ja organizohet në njësi kryesore (fakultete/institute) dhe njësi bazë (departamente/qendra të kërkimit shkencor). Në lidhje me zbatimin e detyrimeve administrative, Universiteti organizohet në drejtori dhe sektorë. **[A1.15]** Organizimi i USH-së është në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 dhe në interes të përmbushjes së misionit dhe objektivave të institucionit. Universiteti i Shkodrës përbëhet nga 6 njësi kryesore, që organizohen më tej në njësi bazë. **[RVV, f. 8, 9]** Njësitë kryesore janë Fakulteti i Shkencave Shoqërore (4 departamente), Fakulteti i Shkencave të Edukimit (4 departamente), Fakulteti Ekonomik (3 departamente), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (4 departamente), Fakulteti i Drejtësisë (3 departamente), Fakulteti i Gjuhëve të huaja (3 departamente), si dhe dy Qendra Kërkimore, përkatësisht: Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore. **[RVV, f. 8, 9]**

1.8 Krahas kësaj, USH-ja ka faqen e vet të internetit, ku paraqiten informacione për programet e studimit, mësimet, të dhëna mbi stafin akademik, raporte për mbledhjet e rektoratit, vendime të Senatit Akademik, vendime të Bordit të Administrimit, projekte, mundësi mobiliteti, etj. <https://unishk.edu.al/> **Kapitulli III, Standardi II.1**

1.9 Organet kolegjiale të USH-së janë si vijon: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Asambleja e Personelit Akademik, Komisionet, Këshilli i Etikës, Rektorati, dhe Dekanati. Këto organe funksionojnë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe marrin vendime të rëndësishme ose japin rekomandime për veprimtaritë e UT-së, njësive kryesore (fakultetet) dhe njësive bazë (departamentet), sipas dispozitave të statutit dhe rregulloreve. **[B1.1, M2, M9] Kapitulli III, Standardi II.3**

1.10 USH-ja përpiqet të monitorojë punësimin e studentëve të diplomuar gjatë viteve, zakonisht një vit pas diplomimit. Ndonëse pas procesit të parë të akreditimit u dha rekomandimi për ngritjen e një bazë të dhënash mbi alumnit, nuk janë paraqitur evidenca të qarta mbi këtë fakt. Gjatë mbledhjes me alumnit, i pyetëm nëse universiteti mbledh të dhëna për punësimin e tyre, por nuk morëm përgjigje pozitive. **[M6]** Institucioni informohet vazhdimisht për zhvillimin rajonal ekonomik përmes burimeve të ndryshme të informacionit, si dhe bashkëpunimit me institucione të tjera, krahas ndjekjes së konferencave ku adresohet çështjet e zhvillimit rajonal. USH-ja ka kryer një studim të tregut të

punës, që e ndihmon të caktojë prioritetet e programeve të reja të studimit, mbështetur në nevojat e qarkut. **[B1.15, M1, M6] Kapitulli III, Standardi III.1**

1.11 USH-ja i kushton vëmendje të veçantë bashkëpunimit me institucione të tjera duke qenë aktiv në këtë aspekt, nëpërmjet bashkëpunimit si partner në projekte të ndryshme, dhe ndërveprimit të ngushtë me institucionet e arsimit të lartë. Në veprimtarinë e tij, USH-ja përpiqet të gjejë ekuilibrin midis konkurrueshmërisë dhe bashkëpunimit, brenda vendit dhe në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në strategjinë 2017-2021, USH-ja përcakton qartë zhvillimin e mëtejshëm të planit të ndërkombëtarizimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit afatmesëm dhe afatgjatë. **[A1.18, M1] Kapitulli III, Standardi III.2**

1.12 USH-ja bashkëpunon me disa institucione të tjera për ofrimin e shërbimeve për studentët, në kuadër të praktikave profesionale (me DAR Shkodra, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Shkodër, Spitalin Rajonal Shkodër, Drejtorinë e Tatimeve Shkodër, OJF, etj.), duke ofruar akomodim për studentët (me SHA "Student"), etj. Krahas kësaj, gjatë mbledhjeve me studentët, alumnit dhe partnerët, është bërë e qartë që **USH-ja ka marrë masa për të lidhur bashkëpunim të shëndoshë me institucionet publike dhe private**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se ky është pohim i Universitetit. **[B1.13] Kapitulli III, Standardi III.3**

### **Gjetjet**

#### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë

#### **Dobësitë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Universiteti i Shkodrës duhet të përmirësojë kanalet e informacionit midis strukturave të tij. **Kapitulli III, Standardi I.2**
- Në nivel Departamenti nuk ka autonomi financiare. **Kapitulli III, Standardi I.4**

#### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Informacioni duhet të qarkullojë më mirë nga nivelet e larta të menaxhimit në ato më të ulëtat dhe anasjelltas. **Kapitulli III, Standardi I.2**
- Universiteti i Shkodrës duhet të gjejë një mënyrë për të krijuar autonomi financiare në njësinë bazë. **Kapitulli III, Standardi I.4**

#### **Pohimi i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pohimin e mëposhtëm:

- Universiteti i Shkodrës ka marrë masa për të lidhur bashkëpunim të shëndoshë me institucionet publike dhe private për mbështetjen e studentëve gjatë trajnimit praktik dhe punësimit të tyre në të ardhmen. **Kapitulli III, Standardi III.3**

**Gjykimi**  
**Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur**  
**kryesisht.**

**Fusha e vlerësimit 2: Burimet**

2.1. Universiteti i Shkodrës përbëhet nga staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe personel administrativ. Të tri kategoritë e punonjësve lidhin kontrata punësimi në nivelin e njësisë akademike, përkatësisht me Fakultetet, që nënshkruhen nga Rektori. Rektorati dhe organe kolegjiale të tjera punësojnë staf në nivelet përkatëse sipas organigramës [A1.15] [B2.1]. Krahas kësaj, Rektori përshkroi organizimin e IAL-së [M1]. Ka procedura të unifikuara për rekrutimin e stafit akademik në nivelin e njësisë akademike të IAL-së, të cilat publikohen në faqen e internetit të Universitetit <https://www.unishk.edu.al/njoftime-per-punesim>. Secila njësi akademike përcakton nevojat për stafit akademik në fund të çdo viti akademik (zakonisht gjatë muajve të verës, kryesisht në korrik), dhe më pas fillon me procedurat e rekrutimit të stafit [M3]. Universiteti ka rregullore të brendshme për rekrutimin, ku specifikohen kriteret dhe procedurat e punësimit [A2.2] ose [C6]. Sikundër parashtrohet në rregulloren për rekrutimin e stafit akademik, si stafi me kohë të plotë, ashtu edhe ai me kohë të pjesshme, punësohen bazuar në parimin e meritokracisë. IAL-ja ka staf akademik të brendshëm (me kohë të plotë) prej 184 anëtarësh, dhe të jashtë (me kohë të pjesshme) prej 323 anëtarësh [C7]. **Kapitulli III, Standardi IV.1**

2.2. Universiteti nxit angazhimin për të zbatuar politikat integruese të stafit akademik dhe administrativ mbi çështje formale dhe joformale, që realizohet në Zyrën e Ekselencës, e cila ka rregulloret e veta [A4.14] me veprimtari të vërtetuara [B3.19]. Zyra e ekselencës ka programin për trajnimin e stafit akademik për periudhën 2019-2020 [B4.12]. Gjatë mbledhjeve me stafin akademik [M10], Grupi i Vlerësimit të Jashtë vërejtë se Zyra e Ekselencës dhe fakultetet organizojnë trajnime të rregullta për stafin akademik me kohë të plotë, të sapopunësuar, dhe pedagogët. Zyra e Ekselencës është shumë aktive në përmirësimin e performancës akademike dhe mësimdhënëse të Universitetit. **Kapitulli III, Standardi IV.2**

2.3. IAL-ja ka miratuar strategjinë e zhvillimit për periudhën 2017-2021, [A1.18] ku parashtrohet misioni dhe vizioni i Universitetit, si dhe gjashtë strategjitë e sektorëve prioritarë. Krahas kësaj, Universiteti ka miratuar strategjitë sipas sektorëve, si mësimdhënia [A4.11], ku përcaktohen prioritetet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies; kërkimi dhe novacioni [A4.21], si dhe komunikimi dhe informacioni [A5.4]. IAL-ja organizon aktivitete sociale dhe integruese në nivel institucional, duke përfshirë konferenca akademike, veprimtari të studentëve, ditë të hapura dhe festivale të tjera [B2.7].

2.4. IAL-ja vazhdon praktikën e vlerësimit të pedagogëve në nivelin e njësisë akademike. Vlerësimi i stafit akademik kryhet nga studentët, sipas performancës [C11]. Një formë e vazhdueshme e vlerësimit të kursit nga studentët bazohet në formularë standardë [C4]. Pyetësorët përmbajnë aspekte të qëndrueshme të vlerësimit të pedagogëve. Po këta formularë arkivohen në skedarët elektronikë të

USH-së, duke ruajtur parimin e konfidencialitetit. Vlerësimi i kurseve dhe pedagogëve ka rëndësi madhore, pasi rritet cilësia e mësimdhënies dhe përmirësohet ripërzgjedhja e pedagogëve, në nivelin e fakultetit. Ekzistojnë evidenca se IAL-ja ka lidhur bashkëpunim me Universitete brenda dhe jashtë vendit **[B1.13]**. Ndërkaq, stafi akademik nxitet që të ndjekë konferenca në nivele të ndryshme, duke përfshirë edhe projekte të ndryshme, si Erasmus+ **[B1.14][B1.9]**. Universiteti angazhon edhe staf të huaj (nga institucione arsimore jashtë vendit) në proceset e mësimdhënies, vlerësime, dhe detyra të tjera akademike në njësitë e veta **[B4.18]**. **Kapitulli III, Standardi IV.3**

2.5. Krahas pedagogëve dhe studentëve, IAL-ja organizon veprimtari sociale, çka vërtetohet në faqen e internetit të Universitetit [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al), dhe gjatë hartimit të këtij raporti u bënë thirrje për aktivitete sociale të ndryshme, si: “Fushatë depistimi falas për matjen e glicemisë, në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese në muajin e diabetit”, ose “Panairi i punësimit dhe vullnetarizmit 2019”. Përmes këtyre veprimtarive, IAL-ja ndjek politika sociale të qëndrueshme, me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e kujdesit shëndetësor në vend. IAL-ja ka evidenca se studentët janë shumë aktivë në organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, që mbulohen nga Universiteti ose fakultetet dhe departamentet e tij **[B3.31]**. Këto aktivitete kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi marrëdhëniet emocionale, sociale dhe arsimore të të gjithë pjesëmarrësve. **[RVV, faqja 23]**. Krahas kësaj, u vërtetua se puna vullnetare e studentëve dhe institucionit akademik synon të ndihmojë njerëz në fusha të ndryshme, **[B2.11], [B2.12]**. Për më tepër, Laboratori i Fizioterapisë **[B2.23]** ofron shërbime shëndetësore për komunitetin vendor. **Kapitulli III, Standardi IV.4**

2.6. Organigrama e IAL-së **[B2.1]** është e qartë dhe përfshin të gjitha njësitë akademike, zyrat e universitetit, si dhe organet kolegjiale. Organigrama mbështetet në legjislacionin kombëtar dhe rregulloret e brendshme **[A1.15]**. IAL-ja ka rregullore të brendshme për rregullimin administrativ **[A1.1]**. Çdo zyrë ose njësi e Universitetit ka rregullore që përcaktojnë detyrat dhe qëllimet **[A4.20] [A5.12] [B4.14]**. Punonjësve iu kërkohet të përmbushin detyrimet kontraktuale, duke përfshirë funksionimin e njërive, ku janë angazhuar. Ekziston edhe zyra e burimeve njerëzore të universitetit, që kujdeset për dokumentacionin e punonjësve duke e përditësuar. Pas vizitës në terren dhe mbledhjes me senatin **[M2]**, u përshkrua metodologjia e rekrutimit të stafit. Në Raportin Vjetor të Auditimit dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit **[B1.10] [B2.16]** paraqiten vëzhgime dhe sugjerime në lidhje me gjetjet e IAL-së për shumë çështje të lidhura me studentët dhe pedagogët. **Kapitulli III, Standardi II.2**

2.7. IAL-ja zbaton rregullat dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e financave, dhe vendimet e Bordit të Administrimit **[B1.2]**. Universiteti ka një strategji të buxhetit afatmesëm për tre vjet. IAL-ja financohet kryesisht nga buxheti i shtetit, sipas raporteve financiare për vitin fiskal 2018: 60% e buxhetit të IAL-së financohet nga Shteti, ndërsa 40% nga burimet e veta të të ardhurave, pra nga shërbimet e Universitetit me palë të treta, projekte të ndryshme, grante, dhe tarifatat studentore **[C9]**. Bordi Administrativ i Universitetit ka kompetenca për përgatitjen e buxhetit sipas prioriteteve **[B2.13]**. Alokimi i buxhetit miratohet nga Senati i Universitetit **[B2.14]**. Njësitë akademike nuk kanë autonomi financiare, ndërsa buxheti është i qendëruar në nivel Universiteti **[M9]**.



Shpenzimet e buxhetit menaxhohen nga bordi i drejtorëve dhe raportohen pranë Senatit. Shpenzimet e buxhetit të Universitetit bëhen transparente në nivelin e senatit, fakultetit dhe departamentit. Duke qenë se janë pjesë e Bordit të Administrimit dhe Senatit, edhe studentët informohen për çështjet buxhetore. Zakonisht, fakultetet i kërkojnë organit kolegjal dhe Rektorit informacione në lidhje me buxhetin vjetor **[B2.15]**. Gjatë mbledhjes me stafin administrativ të Universitetit **[M3]**, drejtori ekonomik informoi se drejtorja përbëhet nga tre ekspertë. **Kapitulli III, Standardi VI.1**

2.8. IAL-ja ka detyrimin ligjor që të kryejë raportin vjetor të auditimit **[B2.16]**. Në raportin e auditimit më të fundit për periudhën janar-dhjetor 2018, janë bërë vërejtje dhe janë dhënë rekomandime në lidhje me menaxhimin e buxhetit. Ka procedura për miratimin e buxhetit vjetor, zërat e buxhetit, dhe transparencën e sistemit të shpenzimeve të buxhetit. Rektorati përfshin departamentin e financës, i cili është përgjegjës për çështjet financiare. Senati i Universitetit merr vendime mbi buxhetin, çka vërtetohet nga evidencat **[B2.14]** për miratimin e kuotave të projektbuxhetit 2019-2021. **Kapitulli III, Standardi VI.2**

2.9. Sipas **RVV-së**, IAL-ja është objekt i legjislacionit dhe rregulloreve kombëtare për menaxhimin e sistemit buxhetor, si dhe menaxhimin dhe kontrollin financiar. IAL-ja iu nënshtrohet auditimeve financiare të jashtme, si dhe atyre periodike, të brendshme. Raportet e auditimit miratohen nga organet kolegjiale të Universitetit, si Senati dhe bordi i menaxhimit. **Kapitulli III, Standardi VI.3**

2.10. "U-Albania, University Albania" <https://ualbania.al>, është një portal, që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet e universiteteve në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), që i ofron Universitetit hapësirë në bazën e të dhënave për mësimdhënien, mësimnxënien, kërkimin, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative. Si rrjet për aksesin në IAL-në USH, ESSE3 **[B2.17]** është platforma ku gjendet informacion për universitetin, duke përfshirë fakultetet, programet e studimit, mësimdhënien në universitet, literaturën, oraret e provimeve, profilet e studentëve, etj.

<https://www.rash.al/sq/universitete/universiteti-luigj-gurakuqi-shkoder-1/> që i ndihmojnë personat e interesuar. SMAK <https://smak.unishk.edu.al/home>, është një aplikacion akademik që përmban rezultatet e nevojshme për menaxhimin akademik **[RVV, faqja 25]**. Kurrikula e programeve të studimit mund të aksesohet përmes këtij portali, por syllabuset e kurseve nuk janë të disponueshme. IAL-ja ka një faqe interneti [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al), ku publikohen statistika periodike për programet e studimit, veprimtaritë e Universitetit dhe njësive akademike, përkatësisht departamentet e tyre, dokumente të USH-së, si Statuti i Universitetit **[B1.1]**, rregullore funksionale dhe të tjera. Në USH nuk ka Drejtori të Informacionit dhe Teknologjisë, që kujdeset për fushën e teknologjisë së informacionit për të pasqyruar veprimet e njësive akademike dhe departamenteve të tyre me orët e mësimin, oraret e provimeve, njoftimet për veprimtaritë akademike dhe vendime të ndryshme të Universitetit. IAL-ja ka hartuar strategjinë e sektorit për "Komunikimin me Publikun dhe Informacionin", në vitin 2016 **[B5.4]**. **Kapitulli III, Standardi VII.2**

2.11. Kampusi i Universitetit të Shkodrës ndodhet në qendër të qytetit dhe përfshin disa godina të veçanta, të cilat nuk gjenden në afërsi të njëra-tjetrës. Ato janë

grupe godinash ku ndodhen disa nga njësitë akademike. Disa nga godinat janë më të vjetra (janë ndërtuar disa dekada më parë), ndërsa objekti i Fakultetit Ekonomik është ndërtuar së fundmi. Brenda kampusit të universitetit organizohen hapësirat e bibliotekës, laboratorëve dhe administratës. Asetet dhe hapësirat e godinave ku zhvillohet mësimdhënia menaxhohen nga universiteti **[C15]**. Pjesët e brendshme të mjediseve në fjalë mirëmbahen rregullisht. Për të përmirësuar hapësirat me qëllim kursimin e energjisë, nevojiten investime të mëtejshme (mbulimi i fasadës së jashtme, rritja e cilësisë së dritareve, etj.). IAL-ja investon rreth 1% të vlerës buxhetore për mirëmbajtjen e godinave dhe hapësirave të mësimdhënies **[A2.15]** **[B2.19]**. Godina e Fakultetit Ekonomik e ka rritur ndjeshëm raportin midis sipërfaqes dhe numrit të studentëve, ndonëse ekziston nevoja për shtimin e sipërfaqes së hapësirave të mësimdhënies. **Kapitulli III, Standardi VII.3**

2.12. Programet e studimit në tri nivele organizohen në Universitetin e Shkodrës, përkatësisht në Fakultetet dhe Departamentet e tij **[B3.1]**. Këto programe studimi nuk janë në kundërshtim me legjislacionin kombëtar, ndaj kultivojnë ruajtjen e trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore. Vizita në bibliotekën e Universitetit ishte shembull i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së shumë shkrimeve, punimeve dhe thesareve kombëtare të tjera **[M8]**. **Kapitulli III, Standardi VII.4**

2.13. Ka tetë godina ekzistuese të kampusit, ku sigurohet kushte të mjaftueshme për procesin e vazhdueshëm të mësimdhënies, veprimtaritë laboratorike, etj., në mënyrë të pavarur dhe të pandërprerë. Krahas kësaj, IAL-ja harton strategji për përmirësimin e cilësinë e aseteve për studentët. Çdo vit investimet kryhen për efekt të riparimit të mjediseve të universitetit, përkatësisht objektet e fakulteteve specifike **[B2.15]** **[B2.19]**. Gjatë vizitave në IAL dhe takimeve të mbajtura **[M6]**, vërehet se studentët përfitojnë akomodim cilësor, në drejtim të ngrohjes/ftohjes të mjediseve. Megjithatë, në godinat ekzistuese nuk ofrohen kushtet për akses të pandërprerë të personave me aftësi të kufizuara. Godinat e akomodimit të stafit akademik janë të ngushta dhe nuk i përmbushin kushtet e punës në mënyrën më të mirë. **Kapitulli III, Standardi VII.5**

2.14. IAL-ja ofron shërbime për palë të treta, në përputhje me nevojat e tregut. Në njësitë akademike ka laboratorë ku ofrohen shërbime për njësitë institucionale të jashtme, si dhe shërbime të drejtpërdrejta për popullsinë, si: laborator mikrobiologjik dhe laborator i fizioterapisë **[B2.23]**. Krahas kësaj, IAL-ja ka kryer studime në lidhje me tregun e punës **[B1.15]**. **Kapitulli III, Standardi VII.6**

2.15. Gjatë qëndrimit në mjediset e IAL-së në përgjithësi, gjatë vizitave të Fakulteteve, Departamenteve, Klasave, laboratorëve, dhe hapësirave sanitare në përgjithësi, u vërejt niveli i lartë i mirëmbajtjes. Klasat i kanë hapësirat bazë të mësimdhënies. Shumë nga fakultetet janë ndërtuar kohë më parë dhe kërkojnë investime, me qëllim rritjen e cilësisë dhe asistencës më të mirë. Të gjitha godinat universitare ndodhen në qytetin e Shkodrës dhe janë në afërsi të njëra-tjetrës. Sipërfaqja e përgjithshme e mjediseve të fakultetit të IAL-së sipas evidencave **[B2.25]** dhe **[C15]** është 21,576,32m<sup>2</sup>, ndërsa sipas **[RVV, faja 28]** është 19,607,00m<sup>2</sup> **[B2.25]**, përjashtuar Fakultetin Ekonomik. Nga kjo sipërfaqe, 16% përbëhet nga mjediset e mësimdhënies, 8.4% nga laboratorë, 7.4% nga hapësirat e stafit akademik, 8.7% nga hapësirat e bibliotekës; rreth 60% nga mjedise teknike, sportive, tualete, etj. Për sa iu përket godinave ekzistuese, mund të vërtetohet se i

përmbushin kërkesat teknike për mësimdhënie të rregullt, në drejtim të ndriçimit natyror dhe me elektriciteti, orientimit të godinës, hyrjes, ngrohjes, pritave e erës, etj. Gjatë vizitave në godinën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, u identifikua dobësia e mungesës së dritës natyrale në sallat e stafit mësimdhënës. Mbështetur në numrin e përgjithshëm të studentëve të IAL-së, përkatësisht 8.203 **[B5.6]**, raporti i sipërfaqes së godinave me numrin e studentëve konsiderohet si dobësi. Vlera e hapësirës fizike ( $21576.32/8,203=2.63 \text{ m}^2/\text{student}$ ) për student nuk i përmbush standardet, sipas të cilave vlera minimale duhet të jetë 3.8 - 4.0 m<sup>2</sup>. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon IAL-së që të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur të gjitha standardet që kërkohen për hapësirë fizike. Megjithatë, IAL-së planifikon të rritë kapacitetet e godinave të veta, çka dëshmohet nga godina e re e Fakultetit Ekonomik. **Kapitulli III, Standardi V.1**

2.16. IAL-ja ka një sistem të organizuar për ruajtjen e dokumentacionit në format elektronik ose të shtypur. Gjatë vizitës në mjediset e Bibliotekës, vërehej kujdesi i madh dhe ruajtja fizike e dokumentacionit të bibliotekës, si dhe arkivimi i materialeve elektronike. Të dhënat e studentëve individualë mirëmbahen nga Sekretaria e Fakultetit **[M12]**, përkatësisht ESSE3, që është baza e të dhënave elektronike të studentëve. **Kapitulli III, Standardi V.2**

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Disa nga zyrat e stafit mësimdhënës nuk i përmbushin kriteret teknike për shërbime teknike të përshtatshme (**Kapitulli III, Standardi V.1**).

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Zyrat ekzistuese të stafit mësimdhënës duhet të riorganizohen në një mënyrë që rrit standardet teknike për hapësirat e punës dhe ofrohet ndriçim natyral (Pika 2.15; **Kapitulli III, Standardi V.1**).

### Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pohimin e mëposhtëm:

- Universiteti i Shkodrës ka marrë masa për të përmirësuar hapësirat në dispozicion të stafit dhe studentëve **Kapitulli III, Standardi V.1**

## Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur Kryesisht.

### Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

3.1. IAL-ja ofron degët Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave, si dhe një program studimi doktorature për gjuhën shqipe [www.asc.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit]. Programet e studimit janë të akredituara, publike dhe të disponueshme në faqen e internetit të Universitetit të Shkodrës. Po e njëjta fushatë është organizuar nga USH-ja duke angazhuar stafin akademik të FSHN-së drejtpërdrejt në punën në terren. Krahas kësaj, USH-ja organizon veprimtari të rëndësishme, të quajtura “Ditët e hapura”, në shkollat e mesme të qytetit dhe më gjerë, si dhe vendos kontakte të drejtpërdrejta me drejtorët e shkollave të mesme [B2.7]. IAL-ja ofron një gamë të gjerë programesh studimi bazë të sintetizuara në mënyrë të tillë, që pasi përfundojnë studimet, studentët kanë mundësinë të bëhen pjesë e tregut të punës ose të vazhdojnë studimet në ciklin Master, në programe paralele. Organet kolegjiale të IAL-së ndërmarrin veprime për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përkatësisht NJSBC-ja. **Kapitulli I, Standardi I.1**

3.2. Misioni dhe vizioni i IAL-së iu përcillet njësive akademike dhe departamenteve përkatëse për t'i përfshirë në programet e studimit. Programet e arsimit të lartë në këtë IAL sigurojnë vazhdimësi përmes programeve të nivelit Master. Krahas kësaj, IAL-ja ofron programe studimi në nivelin Master Profesional, me synim futjen e stafit në tregun e punës. Universiteti i Shkodrës i kushton vëmendje të veçantë ofrimit të kurseve trajnuese të vazhdueshme për stafin akademik të brendshëm, por jo vetëm, si Zyra e Ekselencës përmes Laboratorit të Trajnimit [B3.21]. Strategjia e sektorit [B4.11] parashikon qëllimet e institucionit për trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik të brendshëm të USH-së. Universiteti nuk ofron programe studimi me kohë të pjesshme. **Kapitulli I, Standardi I.2**

3.3. Oferta akademike është pjesë integrale e strategjisë së zhvillimit të HEI-t dhe përputhet me elementet e tjera, si: kërkimi, partneriteti, novacioni, etj. Të gjitha programet e studimit që ofrohen në Universitetin “Luigj Gurakuqi” janë në pajtim me objektivat e strategjisë së zhvillimit 2017-2021 [A1.18], si dhe të gjitha strategjitë e sektorit [A4.21, A5.4, A4.11]. Strategjia Sektoriale e Mësimdhënies [A4.11] parashtron objektivat e IAL-së për ngritjen e kapaciteteve akademike, me qëllim mësimdhënien cilësore. **Kapitulli I, Standardi I.3**

3.4. IAL-ja ofron programe studimi në përputhje me politikat kombëtare të përgjithshme dhe sigurojnë mobilitet në universitete jashtë vendit për studentë dhe pedagogë, çka vërteton shkallën e ndërkombëtarizimit të programeve [B3.28]. Veç kësaj, Universiteti lehtëson edhe mobilitet për studentë të ftuar. Universiteti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me universitete jashtë vendit [B2.6]. Mobiliteti i pedagogëve vërtetohet përmes dokumentacionit [A4.12] **Kapitulli I, Standardi I.4**

3.5. Ngarkesa mësimore e pedagogëve në IAL është ngarkesa vjetore e plotë prej 1536 orësh [A3.16] [C8]. Kjo ngarkesë përfshin mësimdhënien, kërkimin, punën institucionale, etj. [M3]. Pagesat e pedagogëve parashikohen nga aktet nënligjore. IAL-ja tregon sesi vendimet shoqëruese mund të riorganizojnë ngarkesën e pedagogëve. Ngarkesa mësimore shtesë financohet nga buxheti i Universitetit.

Ngarkesa mësimore vjetore e përgjithshme për stafin akademik që angazhohet me detyra administrative është e kategorizuar. Ka pasur raste kur një pedagog kishte ngarkesë administrative me kohë të plotë dhe nuk jepte mësim, por programit të studimit i mungonte stafi akademik i brendshëm. Ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik iu mundëson të angazhohen me kërkime shkencore ose administrative, si: mësimdhënia, kërkimi, puna institucionale, etj. Pagesat e pedagogëve parashikohen nga aktet nënligjore [B4.10]. IAL-ja tregon sesi vendimet shoqëruese mund të përmirësojnë ngarkesën e pedagogëve. Ngarkesa mësimore shtesë financohet nga buxheti i Universitetit. **Kapitulli I, Standardi I.5**

3.6. Kurrikula e programeve të studimit për të gjitha njësitë akademike gjendet në faqen e internetit të Universitetit, si: Fakulteti i Shkencave të Natyrës – Program Studimi Bachelor i Shkencave – Kimi, [https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/Programet\\_e\\_studimit/FSHN/BIK-A.PDF](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/Programet_e_studimit/FSHN/BIK-A.PDF). Në faqen e internetit mungojnë syllabuset, ndaj Universiteti duhet t'i hedhë në sistem. Sipas [RVV, faqja 35], [A3.2] programet e studimit synojnë aftësitë profesionale duke ndërthurur teorinë me praktikën, me qëllim rritjen e mobiliteti të studentëve dhe stafit akademik. Objektivat e programeve të studimit janë në përputhje me objektivat e përgjithshme të Institucionit. Kriteret e pranimit të studentëve [B3.13][B3.14][B3.15] respektohen sipas legjislacionit dhe kuotave në nivel shteti, të cilat publikohen në faqen e internetit të universitetit [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al). **Kapitulli I, Standardi I.6**

3.7. Programet e studimit bazë të ciklit të parë iu mundësojnë studentëve të ndjekin studime në të njëjtat programe Masteri, pas përfundimit të studimeve të tyre. Programet e studimit të ciklit të parë iu mundësojnë studentëve që të mbledhin kredite (ECTS), të konceptuara për një program specifik, dhe të aplikojnë për studime të mëtejshme në nivelin Master. Studimet bazën iu ofrojnë studentëve formim bazë, duke zgjeruar fushat e studimit më tepër. Pas përfundimit të studimeve bazë, studentët kanë mundësinë të hyjnë në tregun e punës. Krahas kësaj, Universiteti ka krijuar Alumni [B5.20], që pasqyron numrin e studentëve të punësuar në tregun e punës pas diplomimit [C14]. Gjatë vizitës së Grupit në IAL, mbledhja me përfaqësues të alumnive tregoi se shërbimi Alumni është në fillimet e punës, dhe po krijon një bazë të dhënash të shëndoshë dhe të dobishme për të ardhmen [M6] [B5.20], **Kapitulli I, Standardi I.7**

3.8. Fushatat paraprake të IAL-së duke filluar nga maturantët deri te studentët janë shumë të dobishme për orientimin e studentëve. Janë përgatitur udhëzime për orientimin e studentëve. Orientimi më i lehtë është faqja e internetit e Universitetit. Objektivi i Zyrës së Ekselencës është përgatitja e pedagogëve, në mënyrë që studentët të mësojnë sa më shumë të jetë e mundur, përmes metodave të përparuara të mësimdhënies. **Disa nga programet e studimit në njësitë akademike nuk e përmbushin 70% e angazhimit të stafi akademik me kohë të plotë në programet e studimit të ciklit të parë [B3.25]. Kapitulli I, Standardi I.8**

3.9. Angazhimi i stafit akademik në departamentet e tyre prioritizohet nga mësimdhënia dhe kërkimi. Kontributi i pedagogëve kërkohet edhe në shërbime të ndryshme të hartimit të raporteve të punës, si: RVV-ja, rregulloret e punës, etj., [M10]. Programet e Masterit bazohen në nevojat e tregut të punës dhe vazhdimësinë e studimeve nga niveli bazë. Zyra e Këshillimit të Karrierës [A1.21]

është përgjegjëse për marrëdhënien me Alumnit dhe gjurmon nevojat e tregut të punës për staf të përgatitur, ndërsa IAL-ja kryen veprime të matshme, duke nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare për stazhe. Një shembull është marrëveshje me Sandhill College për praktika profesionale [B4.1], IAL-ja ofron një progres raport vjetor në lidhje me praktikën profesionale [B4.3]. Përqindja e stafit të jashtëm është më e ulët se 30% në programe studimi të ndryshme të nivelit Master, sipas nevojës. **Kapitulli I, Standardi I.9**

3.10. Të gjitha nivelet e programeve të studimit konceptohen dhe hartohen në përputhje me sistemin e Bolonjës. Kurrikulat janë të organizuara qartë duke mbledhur kredite ECTS, të cilat lehtësojnë transferueshmërinë dhe mobilitetin e studimeve. Mbështetur në strategjinë e IAL-së, bashkëpunimi ndërkombëtar është prioritet, krahas mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve në programe të ndryshme [B2.6]. IAL-ja kryen veprime të matshme [B4.17] për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve [B3.28], dhe për studentët e rinj dhe pedagogët sipas programeve të studimit të Universitetit, çka duhet theksuar. Universiteti është pjesë e programeve Tempus, Erasmus+, si dhe ka nënshkruar shumë marrëveshje dypalëshe me institucione ndërkombëtare [B1.14]. Disa programe studimi në njësitë akademike organizohen në gjuhën angleze. Të gjithë studentët e diplomuar në programet e arsimit të lartë marrin një suplement diplome në gjuhën shqipe dhe angleze nga IAL-ja. Programet e ciklit të parë përfshijnë gjuhët e huaja, kredite ECTS për semestër/vit, dhe totali i tyre është konceptuar sipas sistemit të Bolonjës, me qëllim mobilitetin e studentëve. **Kapitulli I, Standardi I.10**

3.11. IAL-ja i nxit departamentet që të organizojnë aktivitete sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim përfshirjen e stafit dhe studentëve [B3.31] [B5.18]. Stafi akademik dhe studentët e njohin kuptimin e ECTS-së në programet e tyre. Për të gjitha nivelet e studimit në Universitet pas përfundimit të provimeve, organizohet dokumentet e diplomës. **Kapitulli I, Standardi I.11**

3.12. Programet e studimit në të gjitha nivelet iu ofrojnë studentëve kompetenca profesionale specifike dhe të përgjithshme, që garantojnë pozicionim të mirë në tregun e punës [B1.15]. Studentët e programit të studimit në infermieri (mami dhe fizioterapi) [B2.23] kryejnë stazhe në institucione vendore (klinika/spitale), studentët e programit të mësuesisë kryejnë stazhe në shkolla, ndërsa studentët e programit të ekonomisë kryejnë stazhe në banka, etj. **Kapitulli I, Standardi I.12**

### **Gjetjet**

#### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë

#### **Dobësitë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Disa nga programet e Bachelor-it të Shkencave në psikologji nuk i përmbushin kërkesat e standardeve në lidhje me raportin e stafit akademik me kohë të plotë me atë me kohë të pjesshme, që është 70/30%. (**Kapitulli I, Standardi I.8, Kapitulli I, Standardi I.9**)

#### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Duhet të përmbushet kushti i stafit akademik të brendshëm me kohë të plotë, që mbulon 70% të ngarkesës mësimore të programeve të studimit.  
**(Kapitulli I, Standardi I.8, Kapitulli I, Standardi I.9)**

**Pohimi i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim

**Gjykimi**

**Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.**

## **Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi**

4.1 Universiteti organizon programe studimi për Ciklin e Parë, të Dytë dhe të Tretë, duke marrë parasysh nevojat sipas disiplinës, si: përfshirja e trajnimit praktik dhe profesional (stazhe), sipas nevojës [RVV, f. 42, B3.1]. Puna e stafit akademik për të siguruar vazhdimësi dhe koherencë të besueshme mbështetet në LAL (80/2015) dhe Statutin e USH-së [B1.1]. Universiteti ofron shembuj të organizimit të programeve të studimit, duke përfshirë punësimin e stafit, çka tregon planifikim të kujdesshëm të ekuilibrit të lëndëve në semestra dhe vite akademike [A3.6].

USH-ja ka kapacitete të mjaftueshme për organizimin e trajnimit praktik dhe profesional të studentëve në mjediset e USH-së [B2.19], në bashkëpunim me institucione vendore të tjera dhe aktorë ndërkombëtarë [B4.1, A4.2]. Megjithatë, disa studentë u shprehën se hasnin vështirësi në gjetjen e një institucioni për të kryer praktikën profesionale [M4].

Përgjithësisht, studentët janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies, organizimin e kurrikulës dhe cilësinë e stafit mësimdhënës [C4], si dhe ofrimin e literaturës mbështetëse [M4, M5]. Sidoqoftë, u konfirmua se studentët kërkojnë përfshirjen e aspekteve praktike në programin e studimit, duke përfshirë edhe praktikën e një gjuhe të huaj. Krahas kësaj, aktualisht kohëzgjatja e stazhit është e shkurtër, ndaj duhet marrë në konsideratë mundësinë e pagesës gjatë stazhit [M5].

Pas përfundimit të stazhit, studentët duhet të hartojnë raportin e stazhit dhe vlerësohen me notë, në bazë të rezultateve dhe prezantimit [B4.3]. Megjithatë, për disa fusha lëndore, kurrikula përfshin vizita nga pedagogët gjatë stazhit, të cilët më pas përgatitin një raport [B4.4]

Institucioni ofron tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese, në sasi të mjaftueshme [B2.17, M5], si dhe ka një bibliotekë që mundëson literaturë për studentët [<http://bush.unishk.edu.al/>], dhe programet kanë literaturë bazë dhe ndihmëse të mirëpërcaktuar [B3.2] *Kapitulli I, Standardi II.1*

4.2 Rregullat dhe kërkesat për provimet janë të disponueshme në faqen publike të internetit të Universitetit, [RVV, f. 43, A3.6] dhe studentët raportojnë se përgjithësisht janë të kënaqur me sistemet, rregullat, kërkesat dhe proceset e vlerësimit [C4, M4], por vlerësimi ndryshon sipas stafit akademik [M4]. Përpos kësaj, studentët kanë paraqitur kërkesa që provimet të organizohen më shpesh gjatë vitit [M2]. Megjithatë, disa nga studentët e anketuar, për efekt të këtij vlerësimi, raportuan se ndonjëherë studentët kopjojnë gjatë provimeve. Gjatë mbledhjes me studentët u konstatua se jo të gjithë studentët ishin në dijeni të ekzistencës së Këshillit të Etikës [M5]. Në fakt, disa prej tyre e kanë mësuar këtë informacion nga lëndët e etikës [M5]. Anëtarët e stafit ishin në dijeni të Këshillit të Etikës [M2, A1.9], që e konsideron kopjimin në provim si shkelje dhe parashikon penalitete që mund të zbatohen, të cilat lidhen me deklaratatë të qarta në rregullore për të trija ciklet e studimit. Sistemi i vlerësimit për diplomimin bazohet në rregulloret e studimit [A3.6], dhe teza e diplomës miratohet duke aplikuar paraprakisht në internet.

Studentët konfirmuan se i njohnin kriteret dhe procedurat përkatëse të diplomimit, dhe krahas kësaj i kanë marrë edhe diplomat dhe suplementet e diplomës zyrtare



**[M4, M5]**. Megjithatë, në vitin e tretë ekziston një kërkesë mesatare për zhvillimin e tezës së diplomës. Studentët që nuk i përmbushin këto kërkesa, i nënshtrohen një provimi me shkrim, që përfshin lëndët e tri viteve, për të cilat ofrohet mbështetje nga pedagogët **[M4]**.

Mbrohet anonimiteti gjatë korrigjimit të provimeve **[B3.6]**, dhe ankimimet, shpeshherë të quajtura ankesa, ndaj rezultateve në provime trajtohet nga një komision i posaçëm **[B4.5]**. Studentët janë në dijeni të këtij procesi, dhe njëri prej tyre ndau një rast **[M5]**. Krahas kësaj, studentët kanë akses në rezultatet e provimeve të tyre përmes sistemit "Esse3" në USH **[B4.6; <https://www.unishk.esse3.u-gov.rash.al/auth/Login.do>]** *Kapitulli I, Standardi II.2*

4.3 Çdo vit akademik, departamentet organizojnë mbledhje për analizat shkencore dhe të mësimdhënies dhe rezultatet e vlerësimit të studentëve **[B4.7, M3]**, vlerësimin e performancës së stafit **[B4.8]**, si dhe planin e punës për vitin akademik të ardhshëm **[B4.9]**.

Për sa iu përket vlerësimit dhe përmirësimit të programeve, NJSBC-ja (pjesë e Departamentit të Kurrikulës, Kërkimit dhe Standardeve) administron anketimet e stafit dhe studentëve. Pyetësorët plotësohen dy herë në vit, përkatësisht në fund të semestrit të parë dhe të dytë, nga studentë të përzgjedhur në mënyrë rastësore **[RVV, f. 43, M4]**, ndonëse nuk lidhen veçanërisht me pedagogët. Ata lidhen me mësimdhënien dhe përmbajnë një seksion komentesh, ku studentët mund të japin vërejtje për pedagogët **[C4, M4]**. Studentët u shprehën se pyetësorët online vijnë përmes email-it dhe iu dërgohen të gjithë studentëve **[M4, M5]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtë u informua se në disa fakultete, pedagogët iu shpërndajnë studentëve pyetësorë individualë **[M4]**. Studentët nuk marrin përgjigje në lidhje me rezultatet e vlerësimit, por kanë dëgjuar se disa nga anëtarët e stafit akademik janë penalizuar për performancë të ulët, në drejtim të vlerësimit **[M5]**. Krahas kësaj, Grupit iu tha se në studimet e ciklit Master, ka lëndë që nuk shpjegohen hollësisht dhe ngjasojnë lëndët e ciklit Bachelor, si dhe nuk përfshihen aspekte praktike **[M5]**. Gjithashtu, departamentet diskutojnë për ngarkesën mësimore të vitit akademik të ardhshëm **[A3.16, M2, M3]**.

Departament i analizojnë të dhënat **[C4]** dhe sugjerimet e studentëve për të hartuar raporte vjetore **[M2]**, që bëhen pjesë e raporteve të fakultetit për veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit, disa prej të cilave prodhohen sipas vitit kalendarik dhe disa të tjera sipas vitit akademik. Raportet kalohen në Departamentin e Kurrikulës, Kërkimit dhe Standardeve përpara se të përfshihen në një raport mbaruniversitar nga Rektorati, dhe të miratohen nga Senati **[M3, RVV, f. 44]**. Si Universiteti, ashtu edhe studentët ofruan shembuj të ndryshimeve të kurrikulës, pas sugjerimeve të studentëve dhe stafit **[M2, M4, B4.10]**.

Universiteti monitoron punësimin e të diplomuarve sipas departamenteve, një vit pas diplomimit të tyre **[B1.15]**, dhe më pas përditëson Strategjinë e Studimit të Tregut të Punës **[A4.10]** *Kapitulli I, Standardi II.3*

4.4 Institucioni promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes Kurrikulës, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve **[B2.1]**. Me qëllim përmbushjen e standardeve të mësimdhënies, me vendim të Senatit Akademik të USH-së, Nr. 264, datë 15.07.2019, në FSHE u ngrit Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar **[RVV, f. 44, B4.11]**, si dhe politikat dhe procedurat në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies paraqiten në Strategjinë e Mësimdhënies

**[A4.11]**. Megjithatë, që prej ngritjes së qendrës në korrik 2019, stafi i është nënshtruar trajnimi në kuadër të projektit “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri” (TEAVET) (ERASMUS+), që u ofrua në një modul dyditor për “Psikologjinë e Zhvillimit të Fëmijës”. Megjithatë, aktualisht është e vështirë të vlerësohet qëndrueshmëria e Laboratorit të Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar.

Në RVV u vërejt dhe Grupi u informua **[M12]** se stafi trajnohet për mësimdhënien nëpërmjet Qendrës së Ekselencës. Me vendim të Senatit Akademik, Nr. 249, datë 17.07.2019, u miratua ndryshimi i emërimit në Zyrën e Ekselencës **[B4.14]**. Zyra e Ekselencës organizon veprimtari trajnuese të ndryshme për pedagogët, në bashkëpunim me Institucione të tjera **[A4.12, A4.13]**, me nismën e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Fakultetit Ekonomik **[A4.14]**. Stafi akademik ka përfutur trajnime për mësimdhënien, me qëllim forcimin e kapaciteteve të mësimdhënies, kryesisht në shkrim akademik dhe “Flipped Classroom” **[M10; A4.12; B4.13]**, organizuar nga Qendra e Ekselencës. Grupi u informua se për shkak të procedurave burokratike, aktualisht është bllokuar një fond për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies **[M2]**. Në Qendrën e Ekselencës, studentët e ciklit Master i Shkencave janë të ftuar të zhvillojnë kurse trajnimi në shkrim akademik, ndërsa stafit akademik i kërkohet kontributi për metoda novatore të mësimdhënies **[M12]**.

USH-ja pranon vazhdimisht anëtarë të rinj të stafit akademike, të cilët zbatojnë metoda të reja të mësimdhënies dhe kërkimit **[B4.15]**. Krahas kësaj, Grupi u informua se janë organizuar disa trajnime për përmirësimin e aftësive në mësimdhënie **[M12]**. Mbështetur në analizën e feedback-ut të studentëve ndaj pyetësorit, Zyrat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë iu kërkoi departamenteve që të hartojnë një raport mbi efektshmërinë e pedagogëve të tyre.

Grupi u informua se cilësia e mësimdhënies sigurohet nga Përgjegjësit e Departamenteve, që mbajnë dosje për çdo anëtar stafi **[M3]**. Pedagogët informohen paraprakisht për kontrollet rastësore gjatë orëve të mësimi **[M3]**. Krahas kësaj, Departamentet analizojnë pyetësorin e studentëve dhe më pas rezultatet e vlerësimeve raportohen pranë drejtuesve të Fakultetit **[M3]**. Megjithatë, akademikët e nivelit të lartë, që janë ngarkuar me vlerësimin e mësimdhënies, mbështeten ndjeshëm në përvojën e tyre si akademikë për të matur performancën. Kjo dukuri kontribuon në dobësinë e identifikuar më poshtë. Grupi u informua se po punohet drejt zhvillimit të disa kriterëve për të vlerësuar performancën e pedagogëve, në mënyrë që vlerësimet të mos jenë subjektive **[M3]**. Krahas kësaj, ata janë trajnuar për vlerësimin e pedagogëve në universitet. Për këtë qëllim, është ngritur një grup pune që harton procedurat e vlerësimit, dhe propozimi është paraqitur, por nuk është miratuar nga senati. Tashmë është ngritur një komision pranë senatit, që po merret me këtë çështje **[M3]**.

Pas intervistimit të stafit të nivelit të lartë, Grupi u informua se pedagogët përfitojnë mbështetje jospesifike, të përgjithshme, në formën e mentorimit joformal, informacioneve për pjesëmarrje në trajnime të ndryshme, si dhe vlerësimin e performancës **[M10, M9]**. Megjithatë, ka një lëvizje për mbështetjen e pedagogëve, e cila për shkak të kufizimeve të mbështetjes ndaj stafit të ri, kontribuon në dobësinë e identifikuar më poshtë.

Sikundër u përmend më sipër, ndonëse USH-ja ka ngritur Laboratorin e Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar në korrik 2019, stafi akademik duhet të trajnohet shpesh për metodat e reja të mësimdhënies, si parakusht për përmirësimin e niveleve akademike. USH-ja duhet të forcojë një sistem të

efektshëm së bashku me procedurat përkatëse, për ta zhvilluar stafin akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikat e mira aktuale **Kapitulli I, Standardi II.4**

4.5 Fakultetet janë njësit bazë të kërkimit dhe mësimdhënies, dhe kërkimi është prioritet dhe bashkërendohet në këtë nivel **[B1.1, M2]**. Institutet e kërkimit shkencor menaxhojnë dhe promovojnë kërkimin **[A4.16, B1.1]** Stafi ka lirinë që të ndjekë interesat e veta kërkimore, me kusht që të kenë të njëjtin drejtim me departamentin **[M11]**. Janë alokuar rreth 6 milionë lekë për kërkimin, por **nuk ka një rregullore për shpërndarjen e tyre midis departamenteve, të cilat nuk kanë as njësi shpenzimi, duke qenë se ndiqet një sistem i qendëruar [M9]. Kjo është dobësi e institucionit.** Grupi u informua se në tri vitet e fundit, në nivel departamenti, nuk është planifikuar alokimi i fondeve për kërkimin, ndaj nuk ka akses në to **[M9]**. Megjithatë, anëtarët e Bordit të Administrimit dhe stafit mësimdhënës u shprehën se ka diskutime në lidhje me alokimin e këtyre fondeve në mënyrën e duhur, teksa ky buxhet shpenzohet. Veç kësaj, Grupi mësoi se ka raste kur disa pedagogë janë paguar për botimet e tyre në disa revista ndërkombëtare përmes këtij fondi, por të gjitha kanë qenë nisma individuale **[M4]**. Kërkimi shkencor kryhet ose individualisht ose në grup **[M11]**. Për shembull, Instituti i Albanologjisë ka tri projekte të vazhdueshme, që financohen nga Universiteti për Shkrimtarët, për të studiuar Territorin Verior, për kulturën, gjuhën dhe historinë e zonës. Ka projekte 5-vjeçare që do të përmbillen me realizimin e botimeve përkatëse **[M11]**.

Instituti Rajonal i Ujërave aktualisht nuk ka staf akademik dhe fonde të mjaftueshme, ndaj kërkimet zhvillohen individualisht, por problemi qëndron se laboratorët nuk janë të akredituar **[M11]**. Për sa i përket faktorit të ndikimit, botimet kryhen në një revistë të përbashkët, sipas një marrëveshjeje me Universitetet e Malit të Zi **[M11]**.

Departamentet nxitin dhe promovojnë përpjekjet për kualifikim shkencor të mëtejshëm të stafit, çka paraqitet në raportin vjetor për punë kërkimore shkencore **[A1. 27]**. **RVV (f. 45)** parashikon se buxheti ofrohet për dy Institutet kërkimore shkencore, por Grupi nuk gjeti dokumente mbështetëse mbi këtë fakt. Raportet për veprimtaritë shkencore përgatiten nga Instituti kërkimor shkencor i Albanologjisë dhe Qendra e Studimit të Ujërave **[B4.16] Kapitulli II, Standardi I.1]**

4.6 Institucioni mbështet vazhdimisht grupet dhe projektet e reja të kërkimit shkencor, duke promovuar politikën e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimin me institucione kërkimore të tjera, në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, për të përmirësuar cilësinë e shkencës dhe kërkimit përmes projekteve të ndryshme **[B1.14, B4.17]**. Anëtarët e stafi marrin pjesë në konferenca të ndryshme **[B3.26]** dhe botojnë shkrime në revista me faktorin e ndikimit **[M11]**, si dhe aplikojnë për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare **[M11]**. **Kapitulli II, Standardi I.2**

4.7 Universiteti ndjek politika për ndërkombëtarizimin e kërkimit përmes marrëveshjeve me organe jashtë vendit **[B4.17, B1.14]**, çka ka sjellë përfitime të prekshme, duke përfshirë shkëmbimin e punonjësve dhe studentëve, hartimin e përbashkët të materialeve dhe programeve të mësimdhënies, ofrimin e pajisjeve kompjuterike, dhe organizimin e konferencave **[B4.18, M4]**. Çdo vit, Universiteti

organizon konferenca kërkimore ose në lidhje me kërkimin, disa prej të cilave nuk zhvillohen në Shkodër [RVV f. 46], dhe konferenca për studentët [M6], nxit stafin që të bëjë oferta për kërkime në bashkëpunim pranë organizatave të jasthme, si Komisioni Evropian [M3]. Një numër i madh punonjësish dhe studentësh kanë përfituar nga bashkëpunimi ndërkombëtar, si programet Tempus dhe Erasmus+ [M3, M6]. Debati specifik promovohet qartë. Megjithatë, sikundër parashtrohet në [RVV, f. 46], përparësi merr Instituti kërkimor shkencor i Albanologjisë dhe Qendra e Studimit të Ujërave.

Krahas kësaj, USH-ja ka përgatitur Strategjinë Sektoriale të Kërkimit dhe Novacionit, ku paraqiten vizioni dhe objektivat e kërkimit shkencor [A4.21].

Stafi akademik boton rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplina të përkatëse në revista kombëtare dhe ndërkombëtare dhe punime konferencash, disa prej të cilëve janë pjesë e bordeve editoriale [B4.24]. Megjithatë, shumica e botimeve të stafit akademik paraqiten në Buletinin e Universitetit të Shkodrës, "Luigj Gurakuqi". [<https://unishk.edu.al/kerkimi-shkencor/buletine>] Kapitulli II, Standardi I.3

4.8 Kërkimet në USH bazohen në strategjitë kërkimore të universitetit [A4.21], dhe dy Institutet kërkimore shkencore mbështeten nga USH-ja për projekte novatore [B1.2]. Këto institute lehtësojnë bashkëpunimin e brendshëm duke bashkuar stafin nga departamente të ndryshme. Krahas kësaj, USH-ja organizon vazhdimisht veprimtari, që promovojnë debat shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor, përmes zhvillimit të leksioneve të hapura, ku angazhohet dhe kontribuon stafi akademik [B4.19] Kapitulli II, Standardi I.4

4.9 Përgjithësisht, stafi është i kualifikuar në kërkim [B4.15] dhe USH-ja e pajis vazhdimisht stafin me bazë materiale [B2.15], por mungojnë pajisjet për kërkime në laboratorë dhe godinat e laboratorëve të rinj [M12]. USH-ja mbështet stafin në kryerjen e studimeve të doktoraturës jashtë vendit [M10] Kapitulli II, Standardi I.5

4.10 Institucioni bashkëpunon ngushtësisht me organet kombëtare shkencore dhe njësi private [B4.21]. Shumë pedagogë kanë vizituar institucione ndërkombëtare për periudha kohore të shkurtra [B4.22]. Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë nxiten që të marrin pjesë në kërkime përmes programeve të studimit, dhe të ndjekin konferenca brenda dhe jashtë vendit [RVV, f. 47, M5, M11].

Megjithatë, është vërejtur se gjatë dy viteve të fundit, për efekt të kërkimit shkencor, stafi akademik dhe studentë kryen vizita në kuadër të programeve ndërkombëtare të ndryshme (CEEPUS, Tempus dhe Erasmus+) [M5, B4.27, B3.27] Kapitulli II, Standardi I.6

4.11 Gjatë dy viteve të fundit, USH-ja ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka mundur botimin e materialeve të konferencave [B3.26]. Krahas kësaj, puna kërkimore nga anëtarët e stafit të USH-së u botua në monografi dhe periodikë, në bazë vjetore [B4.23; B4.24; [www.bush.unishk.edu.al](http://www.bush.unishk.edu.al)].

Stafi nuk përfitoi mbështetje të madhe për botimet ndërkombëtare dhe Universiteti duhet të identifikojë mënyra për të mbështetur botime në revista ndërkombëtare shkencore, duke përmirësuar edhe dukshmërinë e Universitetit.

Është karakteristike që USH-ja ta informojë median e shkruar dhe elektronike për kërkimet që kryejnë [B4.25], si dhe situatën aktuale në Universitet [M2]. Çdo vit,

Universiteti boton një Revistë shkencore, me titull: “Buletin Shkencor”, si dhe një periodik të Institutit Albanologjik të kërkimit shkencor, me titull “Studime Shqiptare” [RVV, f. 48]. Institucioni informohet për veprimtaritë e kërkimit shkencor të stafit akademike përmes analizës së punës shkencore dhe kualifikuese, çdo vit [RVV, f. 48] **Kapitulli II, Standardi I.7**

4.12 Njësitë e vlerësimit për kërkimin shkencor kontrollohen nga Drejtoria e Kurrikulës, Kërkimit dhe Standardeve [RVV, f. 48; [www.unishk.edu.al/sg/node/43](http://www.unishk.edu.al/sg/node/43)]. Krahas kësaj, departamentet e ushtrojnë këtë funksion çdo vit përmes analizimit të kërkimeve shkencore dhe diskutimeve në kontekstin e veprimtarive kërkimore, si dhe hartojnë raporte retrospektive dhe bëjnë plane për vitin pasardhës [RVV, f. 48]. Nuk duhet lënë pa përmendur fakti se institucioni mbron pronësinë intelektuale duke iu dhënë hulumtuesve të drejta ekskluzive dhe duke promovuar veprimtaritë kërkimore [<http://bush.unishk.edu.al/>].

Grupi u informua se institucioni ndjek politika për të nxitur përfshirjen e hulumtuesve të rinj në projekte kërkimore [RVV, f. 48], por pas mbledhjes me studentët u mësua se nuk janë përfshirë drejtpërdrejt në projekte kërkimore [M5]. Megjithatë, disa studentë të ciklit të dytë ndjekin konferenca shkencore, çka ndryshon nga fakulteti në fakultet [M5]. Shumica e studentëve i kryejnë stazhet në biznese me të cilët USH-ja ka lidhur marrëveshje, të cilët gjenden në Shqipërinë e Veriut [B4.26] **Kapitulli II, Standardi I.8**

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Ndonëse është konfirmuar alokimi i fondeve të buxhetit për kërkimin, nuk janë gjetur ende mënyrat e përshtatshme për t'i alokuar këto fonde. **Kapitulli II, Standardi I.1**

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Universiteti duhet të gjejë mënyra më të mira për ta alokuar fondin për kërkimin. **Kapitulli II, Standardi I.1**

### Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pohimet e mëposhtme:

- Universiteti e përmirëson vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies, duke përfshirë stafin e ri dhe me përvojë, përmes Qendrës së Ekselencës. (**Kapitulli I, Standardi II.4; Kapitulli III, Standardi IV.2**).
- Institucioni po përpiqet të forcojë bashkëpunimin shkencor midis Qendrave Kërkimore dhe Departamenteve. **Kapitulli II, Standardi I.2**

**Gjykimi**

**Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përbushur Kryesisht.**

## Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Universiteti ka miratuar Planin e Zhvillimit Strategjik dhe politika e pranimit pasqyron objektivat specifike të këtij plani [A1.18]. Pranimi në universitet kryhet në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”, Statutin e USH-së dhe rregulloret e studimeve për çdo cikël studimi [B1.1, A3.6, B3.14]. Përgjegjësia kryesore për zbatimin e politikës së pranimit është e departamenteve, fakulteteve dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës.

<https://www.unishk.edu.al/sq/content/senati-vendimi-nr-16-dat%20ab-18012017-p%20abr-miratimin-e-kritereve-t%20ab-pranimit-t%20ab-kandidat%20abv%20ab>; A1.21].

Universiteti ruan kontakte me secilin grup të Fakultetit, me institucionet e arsimit të mesëm, nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtorinë Arsimore Rajonale të qytetit të Shkodrës, por edhe me Zyrat Arsimore të qyteteve të tjera në verilindje dhe veriperëndim të vendit. Universiteti organizon ditë të hapura çdo vit për nxënësit e shkollave të mesme [RVV f. 50, M1, M12, B2.7, A1.26, C17]. Departamentet dhe Zyrat e Këshillimit të Karrierës janë përgjegjëse për informacionet mbi pranimet e studentëve të mundshëm dhe të ardhshëm. Departamentet caktojnë tutorë për çdo program studimi, të cilët janë përgjegjës për dhënien e informacioneve mbi programin e studimit dhe planin akademik. Fakultetet i mbështetin studentët, sipas çdo programi studimi, me veprimtari orientimi dhe tutorimi [M10] dhe studentët informohen për tutorët. Për secilin departament sipas programeve të studimit, organizohet shërbimi i tutorimit për secilin grup studentësh [B5.4]. Një grup studentësh përbëhet nga 15 studentë, që kanë një tutor [M4]. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se studentët e ciklit të parë nuk informohen mirë për tutorët e departamenteve të tyre [M4].

Numri i studentëve propozohet nga departamentet dhe miratohet nga Senati Akademik. Ndërkaq, për secilin program studimi, pedagogët prezantojnë mundësitë që ofrohen nga tregu i punës, në përputhje me formimin e studentëve të ardhshëm. Numri i studentëve të rinj të regjistruar është luhatur gjatë tri viteve akademike të fundit [C1].

USH-ja ndjek politika për pranimin e studentëve të huaj. Pranimi i studentëve të huaj mbështetet në rregulloren e studimit [A3.6], dhe faja e internetit <https://unishk.edu.al/studentet-e-ardhshem> ofron informacione për kuotat dhe kriteret e pranimit, duke përfshirë studentët brenda dhe jashtë vendit [B5, B5.1]. Studentët e huaj vijnë kryesisht nga rajoni i Ballkanit dhe gjuha e studimit është gjuha shqipe. Krahas kësaj, studentët me nënshtetësi të huaj studiojnë kryesisht në degën e anglishten, dhe vijnë nga Turqia. Studentët e huaj studiojnë dhe kryejnë punë kërkimore në USH, në kuadër të programeve CEEPUS (Programi i Shkëmbimit të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore) dhe ERASMUS. [B5.2, B5.3] **Kapitulli I, Standardi III.1**

5.2 Dekanati, sekretaria mësimore, sekretaria e Dekanatit dhe njësitë bërthamë të Fakulteteve garantojnë të drejtën e informimit të studentëve. Studentët informohen nga Dekanati, sekretaria mësimore dhe njësi mbështetëse të tjera. Në të gjitha mjediset e Universitetit janë afishuar orare ku studentët mund të marrin informacione, të dhëna mbi certifikatat dhe shërbime të tjera të nevojshme [RVV f. 51, M3, M4, M8, M10], dhe USH-ja publikon informacione mbi konsultimin e studentëve në të gjitha

mjediset e institucionit, por edhe nëpërmjet njoftimeve të rregullta në faqen e internetit [<http://old.unishk.edu.al/sq>].

Për studentët e ciklit Bachelor, mbledhjet zhvillohen në çdo fakultet, në mënyrë që të njihen me programin e studimit dhe mjedisin e Universitetit [A2.7]. Krahas kësaj, informacionet ofrohen edhe në faqen e internetit të Universitetit [[http://old.unishk.edu.al/sq/pranime\\_new\\_students](http://old.unishk.edu.al/sq/pranime_new_students)] dhe mediat sociale [[https://m.facebook.com/Fakulteti-i-Shkencave-Shoq%C3%ABrore-Universiteti-i-Shkodr%C3%ABs-Luigj-Gurakuqi-705034239871273/?modal=admin\\_todo\\_tour](https://m.facebook.com/Fakulteti-i-Shkencave-Shoq%C3%ABrore-Universiteti-i-Shkodr%C3%ABs-Luigj-Gurakuqi-705034239871273/?modal=admin_todo_tour)]. Për të përmbushur nevojat e studentëve, organizohen orare për komunikimin me studentët [A5.4, B5.4].

Që prej vitit 2013, USH-ja ka miratuar sistemin e menaxhimit të studentëve "ESSE3", që kryen funksionin e mbështetjes së procesit të mësimdhënies në mënyrë elektronike [<https://www.unishk.esse3.u-gov.rash.al/auth/Login.do>; B2.17]. Në këtë sistem ka një profil për studentët, që shërben si burim i mirë informacioni për kreditet dhe oraret e mësimin dhe vlerësimit. Studentëve iu pëlqen fakti se në sistemin ESSE3 mund t'i shohin notat e tyre. Në këtë sistem është ngarkuar edhe lista e stafit, me adresat e email-it, në mënyrë që studentët të komunikojnë me pedagogët e tyre. USH-ja ka një bazë të dhënash personale të studentëve, që arkivohen në sekretarinë mësimore dhe përmbajnë numrin dhe adresat e email-it të studentëve. Sekretaria e studentëve është përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e dosjeve të studentëve *Kapitulli I, Standardi III.2*

5.3 Krahas departamenteve dhe Fakulteteve që orientojnë dhe këshillojnë studentët për të gjitha ciklet e studimit, Universiteti ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës për këtë qëllim. Kjo zyrë u hap në dhjetor 2016 dhe filloi ushtrimin e veprimtarisë së saj në shkurt 2017 [A1.21]. Universiteti përdor një sërë instrumentesh komunikimi për t'u siguruar se studentët janë të mirinformuar, si dhe orientojnë nga staf akademik dhe joakademik me përvojë, dhe shumica e informacioneve gjenden në faqen e USH-së. [<https://www.unishk.edu.al/sq/news>]. Ditën e parë studentët ndjekin një mbledhje me stafin akademik, ku prezantohen me burimet e informacionit për kurrikulën. Krahas kësaj, në fakultete ka edhe tabela njoftimesh ku afishohen informacione [M8]. Informacione thelbësore për programet e studimit, rregullore dhe jetën studentore përfshihen në udhëzuesin për studentët e rinj, si dhe udhëzuesi dhe manuali për përgatitjen e diplomës gjenden në faqen e internetit të Universitetit [A3.6, C17, B3.24]. Aktualisht nuk është i mundur ngarkimi i materialeve në ESSE3, por pedagogët iu dërgojnë studentëve materiale mësimore përmes grupeve në motorin e kërkimit Google [M4]. Zyra e kurrikulës dhe Sekretaria Mësimore ofrojnë mbështetje dhe orientim për studentët që duan të ndryshojnë programin e studimit. Ekzistojnë procedura që mundësojnë dhe lehtësojnë procesin e ndryshimit të programit të studimit. Ndryshimi i programit të studimit brenda Universitetit kryhet sipas akteve nënligjore, të miratuara nga MAS-i dhe Rregullorja e studimeve [A3.6, B3.10] *Kapitulli I, Standardi III.3*

5.4 Universiteti iu kushton vëmendje të veçantë studentëve me nevoja të veçanta, si dhe studentëve nga komuniteti rom dhe egjiptian, duke i mbështetur në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar. Për shembull, godina e re e Fakultetit Ekonomik është pajisur me rampa në hyrje, me qëllim lehtësimin e aksesueshmërisë së studentëve me aftësi të kufizuara [RVV, f. 53], por në disa raste, një grup studentësh duhet ta ndryshojnë



klasën nga kati i tretë në kat të parë, në mënyrë që studentët me nevoja të veçanta të ndjekin mësimin **[M4]**. Krahas kësaj, sikundër parashikohet në **[RVV f. 53]**, për studentët me nevoja të veçanta, provimet zhvillohen në katet e para të fakulteteve, në rast se godinat nuk janë përshtatur për këtë kategori. Universiteti ofron mbështetje financiare për grupet e veçanta të studentëve, sikundër parashikohen në VKM Nr. 39 datë

23.01.2019[[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/Bursat/VENDIMI\\_39\\_i\\_KM\\_Date\\_23.01.2019.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/Bursat/VENDIMI_39_i_KM_Date_23.01.2019.pdf); **5.5**]. Studentët nxiten që të merren me sport (edukim fizik dhe sport) dhe mbështeten nga Universiteti sipas rregulloreve **[A5.8]**. Universiteti ofron bursa për studentët me aftësi akademike të shkëlqyera dhe studentët që merren me fushat prioritare, sikundër shpjegohet në:

**[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\_upload/Bursat/VENDIMI\_39\_i\_KM\_Date\_23.01.2019.pdf]**. Më parë studentët përfitonin mbështetje me programet me kohë të pjesshme, por kjo alternativë nuk ofrohet më, ndonëse e kanë të drejtën të kryejnë provime **[B5.6] Kapitulli I, Standardi III.4**

5.5 Çdo departament i USH-së ka programe studimi (në ciklin e parë dhe të dytë) dhe kurrikul për çdo lëndë të ofruar. Çdo syllabus përfshin literaturën e kërkuar, shtesë dhe të rekomanduar **[A3.2]**, por një pjesë e saj duhet të përditësohet në të ardhmen e afërt. Universiteti ofron tekstet mësimore më të mira në gjuhën shqipe dhe angleze për çdo modul **[A3.2]**. Universiteti boton një buletin shkencor, ku pedagogët ndajnë artikuj dhe studime shkencore, që shërbejnë si burime të literaturës ndihmëse për studentët **[https://unishk.edu.al/kerkimi-shkencor/buletine]**. Biblioteka ka marrë përgjigje pozitive në anketimet e studentëve dhe stafit. Duket se biblioteka është e mirëpajisur dhe studentët konfirmuan se shumica e librave janë në gjuhën angleze dhe italiane **[M4]**.

U konfirmua se nuk ka probleme me literaturën, dhe në rast se nuk ka libra në bibliotekë ose në internet, pedagogët ofrohen në gjetjen e tyre **[M4]**. Dokumentet e Universitetit administrohen nga zyra e Arkivës, por çdo njësi ka arkivën e vetë personale për ruajtjen e dokumentacionit përkatës **[A5.10]**.

Biblioteka ka një sipërfaqe prej 3000 m<sup>2</sup> dhe rreth 400,000 libra, si dhe 88% e fondit gjendet në katalogun elektronik dhe mund të aksesohet online. Hapësira e studimit në bibliotekën kryesore zë 300 studentë. Universiteti po kryen digjitalizimin e materialeve të vjetra për të ruajtur trashëgiminë kulturore. Gama e gjerë e librave dhe revistave që mund të aksesohen nga studentët është në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, i mbështetin me efektshmëri studentët në mësimnxënie dhe punë kërkimore. **[RVV f. 53, A2.17, M4, M8]**.

Universiteti e pasuron bibliotekën në mënyrë periodike. Gjatë periudhës 2017-2019, biblioteka u pasurua me libra dhe literaturë nga dhurime dhe botime të stafit akademik të USH-së. Planifikimi buxhetor përfshin pasurimin e bibliotekës. Literatura e re blihet me propozimin e departamenteve individuale. Pedagogët i mbështetin studentët me kopje të librave që kanë botuar në bibliotekë **[M4]**. Oraret e punës të bibliotekës afishohen në mjediset e Universitetit dhe faqen e internetit të bibliotekës. Biblioteka është e hapur deri në orën 19:00 gjatë ditëve të javës, dhe 13:00 ditëve të shtunave. Ka informacione të publikuara online për studentët **[A2.17, A5.12, http://bush.unishk.edu.al]**. Universiteti ka një bibliotekë qendrore, por edhe fakultetet

kanë bibliotekat e tyre vendore. Për studentët ofrohen edhe disa kompjutera dhe fotokopje. Në katin e dytë, studentët mund të punojnë në bashkëpunim. Në bibliotekë ofrohet internet **[M8]**.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka krijuar një bibliotekë digjitale dhe studentët kanë akses në literaturën më të fundit, në fusha të ndryshme të shkencës. Krahas kësaj, në bashkëpunim me RASH, Departamenti i TI-së i USH-së ofron akses në shërbimet e kësaj biblioteke digjitale për të gjithë pedagogët dhe studentët e universitetit **[https://ulibrary.rash.al/ Kapitulli I, Standardi III.5]**

5.6 Çdo Departament ofron shërbime tutorimi për studentët. Janë caktuar oraret e punës për stafin, dhe në rastet kur zyrat duhet ndarë me punonjës të tjerë, ata e gjejnë kohën për të diskutuar individualisht me studentët **[B5.4, M8]**. Veç kësaj, institucioni ofron shërbime tutorimi për procesin e diplomës **[B5.4, M10; M4]** dhe ka përgatitur paketën e provimeve përfundimtare për ciklin Master **[B5.7]**. Oraret e punës për çdo pedagog caktohen në fillim të vitit akademik dhe përfshihen në ngarkesën vjetore të punës **[B3.24]**. Çdo pedagog ka dy orë të disponueshme në javë. Stafi akademik ofron konsultime të planifikuara për t'i ndihmuar studentët, që hasin vështirësi me procesin e mësimnxënies **[B5.4]**. Çdo student ka të drejtë që të ketë një udhëheqës gjatë përgatitjes së tezës së diplomës. Departamenti miraton listën e studentëve dhe emrin e udhëheqësit **[M9]**. Për çdo kurs, pedagogët i ndihmojnë dhe i orientojnë studentët në gjetjen e literaturës **[B3.2]**.

5.7 Studentët kanë një përfaqësues në Bordin e Administrimit **[A1.14, M1]** dhe dy në Senatin Akademik, Këshillin e Fakultetit dhe Këshillin Administrativ. **[1.2 neni 47, pika 2/b; B1.1, M2]**. Përfaqësuesit e studentëve janë të ftuar që të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet dhe i shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për kurrikulën, programet e studimit dhe rregulloret **[RVV, f. 45, M2, M4; A1.9]**. Krahas kësaj, një student nga çdo cikël studimi është pjesë e njësisë të vlerësimit të brendshëm në çdo fakultet. Studentët janë anëtarë të grupeve të vlerësimit të brendshëm për programet e tri cikleve të studimit. Pikëpamjet dhe vlerësimet e studentëve merren parasysh për të përmirësuar programet e studimit. **[RVV f. 53, M4]**, por ky proces nuk është i qartë për disa studentë të Fakulteteve **[M4]**. Në vitin 2018, me qëllim vetëqeverisjen, studentët zhvilluan zgjedhje për të ngritur një Këshill Studentor të ri, si organizatë e pavarur për promovimin e pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje, me të drejtë që të shprehin shqetësimet dhe sugjerimet për jetën universitare **[B5.8, B5.9, B5.10, B5.11]**. Këshilli Studentor i USH-së, gjatë protestave studentore në vitin 2018, adresoi disa çështje specifike me Rektorin e Universitetit dhe Dekanët e fakulteteve përkatëse **[B5.12]**. Studentët kanë adresuar kërkesa shtesë në lidhje me procesin mësimor nëpërmjet Këshillit Studentor **[M2, M4]**.

Krahas kësaj, SUS-i, me politikën e tij, nxit dimensionin social të studentëve, duke mbështetur organizatat dhe sipërmarrjet e studentëve, në projekte të ndryshme të grupeve të studentëve **[B5.13 Kapitulli I, Standardi III.7]**

5.8 Universiteti ofron një gamë të gjerë veprimtarish jashtëkurrikulare (veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare, projekte me natyrë sociale, kulturore dhe sportive) për studentët **[B3.31, M5]** me organizatat dhe institucionet përkatëse **[B3.30]**. “Nisma” është një organizatë vullnetare dhe e pavarur nga Universiteti, që përqendrohet

kryesisht në veprimtaritë sociale të studentëve. Nisma organizohet edhe në klube studentore, dhe vetëfinancohet nga studentët **[M5]**. Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka nxjerrë gazeta studentore, të punuara nga studentët e degëve “Gazetari Komunikimi” dhe “Gjuhë dhe Letërsi”, që prej muajit dhjetor 2015 **[B5.14, B5.15]**. Studentët botojnë artikuj në gazetën studentore dhe e shohin si mundësi promovimi. USH-ja ofron kushtet e përshtatshme për të gjitha veprimtaritë me natyrë sociale dhe kulturore. Universiteti ka Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, i cili i mbështet studentët me organizimin e veprimtarive sportive **[RVV, f. 57, B5.16]**. Krahas kësaj, Universiteti i mbështet studentët që janë anëtarë të ekipeve kombëtare sportive, duke iu ofruar një plan mësimor individual. Departamenti i Infermierisë organizon orë të hapura për veprimtari ndërgjegjësuese mbi mbrojtjen e shëndetit, si dhe lehtëson fushatat e dhurimit të gjakut. Ndërkaq, studentët e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, në bashkëpunim me organizatën jofitimprurëse "ECO Mendja", janë angazhuar sistematikisht me punë vullnetare dhe veprimtari bamirësie për t'i ndihmuar anëtarët e komunitetit **[M5, RVV, f. 57, B5.18] Kapitulli I, Standardi III.8**

5.9 Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon workshop-e dhe panairë pune për të ofruar shërbime eksperte për përgatitjen e të diplomuarve për tregun e punës, dhe çdo fakultet ka një përfaqësues në zyrën e këshillimit **[M12]**. Zyra angazhohet me zhvillimin e panairëve të punës, ku fton punëdhënës dhe studentë.

Panairët e punës organizohet në nivel fakulteti. Për shembull, në Fakultetin Ekonomik **[M12]**, mbledhja e të dhënave organizohet përmes regjistrave, sistemit ESSE3 dhe pyetësorit online, që postohet në faqen zyrtare të internetit të universitetit **[RVV, f. 57]**. Zyra e Këshillimit të Karrierës ka krijuar një bazë të dhënash për alumnit e Universitetit dhe po punon për ta pasuruar sistematikisht, ndërsa departamenti i TI-së ka skanuar dhe ka përpunuar 47 zëra **[B5.19]**. Zyra e Këshillimit të Karrierës në faqen e internetit për Alumnit e ka filluar tanimë regjistrimin e studentëve të diplomuar në USH. Me t'u përfunduar formulari, të gjitha të dhënat ruhen në bazën e të dhënave të USH-së **[B5.20, <https://unishk.edu.al/studentet/alumni/regjistrohem>]**.

USH-ja bashkëpunon në mënyrë proaktive me Drejtorinë Arsimore Rajonale, bizneset vendore, studentët e diplomuar, dhe palë të tjera interesi, për të mbështetur studentët e diplomuar që të bëhen pjesë e tregut të punës **[RVV f. 58, B5.21]**. Universiteti zbaton një politikë punësimi pozitive, duke punësuar studentët e diplomuar në USH. Disa përfaqësues të bankave u shprehën se ofrojnë stazhe, dhe disa studentë të sapodiplomuar thanë se kanë gjetur vend pune fill pas diplomimit **[M6]**. Universiteti ka rekrutuar një numër prej 119 studentësh si staf akademik me kohë të plotë **[B5.22]**. Studentët e diplomuar punësohen më lehtë në sektorin privat. Punësimi në sektorin publik konfirmohet nga Departamenti i Administratës Publike **[M6]**. Stazhet e zhvilluara në institucione vendore dhe letrat e referencës të ofruara nga pedagogët i kanë ndihmuar shumë studentë në gjetjen e vendeve të punës. Studimi i tregut të punës synon analizimin e dinamikave dhe gjetjen e mënyrave për t'i përshtatur programet e studimit, që ofrohen në USH, me kërkesat e tregut dinamik **[B1.15]**. Integrimi i punësimit ofrohet nga FES, FE, FFL, FSS, përmes projekteve në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës (strategjia për zhvillimin e qytetit, strategjia për zhvillimin e turizmit në zonën e Dukagjini), TEULEDEN (për organizimin e panairëve artizanale), Dhomën e Tregtisë, REC, dhe Bashkinë e Shkodrës (për organizimin e panairëve të turizmit). Në

pajtim me institucionet rajonale, studentët zbatojnë praktikën dhe lërojnë rrugën për punësim të mëvonshëm [A.1.21, B5.21].

Zyra e Alumni-ve organizon mbledhje me studentët e diplomuar

[[https://unishk.edu.al/kerko?tx\\_indexedsearch\\_pi2%5Baction%5D=search&tx\\_indexedsearch\\_pi2%5Bcontroller%5D=Search&cHash=d8323a14b2adff477839998ae1404578](https://unishk.edu.al/kerko?tx_indexedsearch_pi2%5Baction%5D=search&tx_indexedsearch_pi2%5Bcontroller%5D=Search&cHash=d8323a14b2adff477839998ae1404578)]. Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon rregullisht veprimtari mbulimi për t'iu ofruar të rinjve mundësi punësimi brenda dhe jashtë vendit [[https://unishk.edu.al/kerko?tx\\_indexedsearch\\_pi2%5Baction%5D=search&tx\\_indexedsearch\\_pi2%5Bcontroller%5D=Search&cHash=d8323a14b2adff477839998ae1404578](https://unishk.edu.al/kerko?tx_indexedsearch_pi2%5Baction%5D=search&tx_indexedsearch_pi2%5Bcontroller%5D=Search&cHash=d8323a14b2adff477839998ae1404578)].

Krahas kësaj, partnerët e jashtëm kanë bërë propozime për programe të reja, si programe sportive [M6]. Alumni-t organizojnë mbledhje, por në shumicën e rasteve janë joformale dhe informacionet përftohen kryesisht nga pedagogët e institucioneve përkatëse. Vërehen dallime midis Alumni-ve të fakulteteve të ndryshme [M6]. Për programin e informatikës ekonomike, partnerët e jashtë të Përfaqësuesve të Fondit të Zhvillimit diskutuan për bashkëpunimin me fakultetin homolog në Zagreb për ta hapur si program të përbashkët.

Disa nga alumnit kanë filluar një veprimtari në lidhje me përmirësimin e cilësisë, rishikimin e kurrikulës, dhe ia kanë ofruar kontributin e tyre Universitetit. Të gjitha këto plane do të plotësohen [M6]. USH-ja kërkon të ruajë kontakte të vazhdueshme me alumnit dhe për këtë arsye ka organizuar mbledhjen "25 vjet FEUNISHK 2018", që u zhvillua nga Fakulteti Ekonomik, ku morën pjesë punonjës dhe alumni për të festuar 25-vjetorin e Fakultetit [B5.23]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** se duhet përgatitur rregullorja e Alumnive dhe duhet përmirësuar baza e të dhënave për alumnit nga Zyra e Këshillimit të Karrierës **Kapitulli I, Standardi III.9**

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Zyrat e Këshillimit të Karrierës po e rrit performancën dhe USH-ja po përpiket të forcojë rrjetin e tutorimit për të rritur efektshmërinë (**Kapitulli I, Standardi III.1**).

- Përgatitja e rregullores së Alumnive dhe përmirësimi i bazës së të dhënave për alumnit nga Zyra e Këshillimit të Karrierës (***Kapitulli I, Standardi III.9***).

### **Gjykimi**

**Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përbushur Kryesisht.**

## Lista e evidencave

Nr.	Përshkrimi
-----	------------

**A - Evidenca nga akreditimi i parë**

1.1	Rregullore e brendshme e administratës
1.9	Kodi i Etikës i USH-së
1.14	Vendim i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ)
1.15	Struktura organizative
1.18	Strategjia 2017-2021
1.20	Vendime të Senatit Akademik (pedagogë të brendshëm të KADM-së)
1.21	Vendimi i Senatit Akademik Nr. 541, datë 30.12.2016 “Për ngritjen e Zyrës së Këshillimit të Karrierës për studentët”
1.22	Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit
1.26	Shembuj të marrëveshjeve të bashkëpunimit
1.27	Analizë e punës shkencore dhe kualifikuese, 2016
2.2	Rregullore për “Gjetjen dhe Mbajtjen e një Pune”
2.3	Vendim i Senatit Akademik për të përditësuar rregulloren e vitit 2016
2.7	Manual i studentit - Fakulteti Ekonomik
2.14	Infrastruktura e TI-së
2.15	Infrastruktura e USH-së
2.17	Manual i bibliotekës
2.18	Vendim i Senatit Akademik për dhënien e titujve të nderit
3.2	Modele të programeve të studimit
3.6	Rregullore për studimet dhe Vendimi Nr. 407, datë 06.10.2016
3.10	Vendim i Senatit Nr. 103, datë 18.03.2015
3.14	Marrëveshje me Universitetin e Napolit
3.16	Marrëveshje midis stafit akademik dhe Departamentit për ngarkesën mësimore
3.18	Modele shtesë
3.21	Lista e kurseve në gjuhën angleze
3.24	Udhëzues për hartimin e tezës së diplomës
4.2	Certifikatë për stazhierët në SHBA
4.10	Strategji e studimit të tregut të punës
4.11	Strategji e mësimdhënies
4.12	Model i një kontrate të nënshkruar nga pedagogët në rastet e mobilitetit
4.13	Marrëveshje me CEEPUS dhe EUREQA
4.14	Rregullore e Qendrës së Ekselencës
4.16	Urdhra për hapjen e Institutit të Studimeve Albanologjike dhe Institutit të Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës
4.20	Rregulloret e instituteve kërkimore
4.21	Strategjia e kërkimit dhe novacionit
5.4	Strategjia e Komunikimit me Publikun dhe Informacionin
5.6	Formular për studentët nga sekretaria për regjistrim
5.8	Vendim për planin e mësimdhënies individuale - Fakulteti i Shkencave të Edukimit
5.10	Rregullore e Arkivës së USH-së
5.12	Rregullore të brendshme të bibliotekës, AMS

## B - Evidenca për këtë proces

Nr.	Përshkrimi
-----	------------

<b>1.1</b>	Statuti i USH-së
<b>1.2</b>	Vendime të Bordit të Administrimit
<b>1.3</b>	Rregullore e Bordit të Administrimit
<b>1.4</b>	Vendime të Këshillit të Etikës
<b>1.5</b>	Vendime të Dekanatit
<b>1.6</b>	Urdhri për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm
<b>1.7</b>	Vendim për ngritjen e NJSBC-së në nivel Fakulteti
<b>1.8</b>	Vendim për ngritjen e NJSBC-së në nivelin e programit të studimit
<b>1.9</b>	Listë projektsh
<b>1.10</b>	Raporti vjetor i USH-së
<b>1.11</b>	Raporti i sigurimit të brendshëm të cilësisë 2017-2018
<b>1.12</b>	Vendim për caktimin e një studenti në Bordin e Administrimit
<b>1.13</b>	Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të USH-së
<b>1.14</b>	Projekti Erasmus
<b>1.15</b>	Studim i tregut të punës
<b>2.1</b>	Strukturë organizative
<b>2.2</b>	Ngritja e grupit të punës për Rregulloren e re “Gjetja dhe mbajtja e vendit të punës”
<b>2.3</b>	Njoftim për vende të lira pune - Vlerësim i kandidatëve me konkurrencë - Miratimi i dekanit - Miratimi i rektorit
<b>2.4</b>	Vendime të Bordit të Pedagogëve për titullin e gradës “Doktor”
<b>2.5</b>	Pedagogët e rekrutuar me gradën “Doktor”
<b>2.6</b>	Mobilitet i përbashkët i stafit administrativ dhe akademik
<b>2.7</b>	Broshura, Ditët e Hapura
<b>2.8</b>	Njohja e titujve dhe certifikatave
<b>2.9</b>	Mësimdhënie në universitetet perëndimore
<b>2.10</b>	Trajnim i stafit nga pedagogë të huaj
<b>2.11</b>	Punë vullnetare dhe veprimtari bamirësie me FGJH-në, ekspozita, shfaqje të FSHE-së
<b>2.12</b>	Mbështetje financiare në rast fatkeqësish
<b>2.13</b>	Urdhri i administratorit për buxhetin
<b>2.14</b>	Vendim i senatit për buxhetin - Vendim i Bordit të Administrimit mbi buxhetin.
<b>2.15</b>	Specifikim i kërkesave për buxhetin sipas departamentit
<b>2.16</b>	Raportet e monitorimit vjetor
<b>2.17</b>	Rregullore e Programit të Digjitalizimit të Sistemit ESSE3
<b>2.18</b>	Evidenca SMAK
<b>2.19</b>	Infrastruktura e USH-së_2
<b>2.20</b>	Masat e mbrojtjes nga zjarri
<b>2.21</b>	Fondi Ephemera, Biblioteka.
<b>2.22</b>	Muzeu zoologjik
<b>2.23</b>	Qendra e Studimit të Ujërave - Laboratori i Mikrobiologjisë - Laboratori i Fizioterapisë
<b>2.24</b>	Mirëmbajtje e mjediseve të USH-së
<b>2.25</b>	Hapësirë për studentët
<b>3.1</b>	Listë e programeve të studimit



<b>3.2</b>	Modele të programeve të studimit, cikli I, II
<b>3.3</b>	Procedura e hartimit dhe miratimit të programeve të studimit
<b>3.4</b>	Dokument Nr. 403, datë 08.05.2019, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
<b>3.5</b>	Informacion për hapjen e programit të studimit "Master Profesional në menaxhim financiar, kontabilitet dhe kontroll në Administratën Publike"
<b>3.6</b>	Vendim i Senatit Akademik Nr. 210, datë 21.06.2019
<b>3.7</b>	Informacion për projektin MARDS
<b>3.8</b>	Udhëzim i USH-së Nr. 289, datë 04.10.2017
<b>3.9</b>	Udhëzim i USH-së Nr. 279, datë 16.07.2018
<b>3.10</b>	Vendim i Senatit Akademik të USH-së dhe Rregullore e Studimit Nr. 182, Shkodër 2019
<b>3.11</b>	Vendim i Senatit Akademik Nr. 16, datë 18.01.2017
<b>3.12</b>	Vendim i Senatit Akademik Nr. 214, datë 16.06.2017
<b>3.13</b>	Përqindjet e pranimit në programin e studimit "Edukim Fizik dhe Sporte"
<b>3.14</b>	Rregullore për zhvillimin e konkursit të pranimit në programin e studimit "Pedagogji në Muzikë"
<b>3.15</b>	Rregullore për zhvillimin e konkursit të pranimit në programin e studimit "Pikturë dhe Grafikë"
<b>3.16</b>	Vendim i Senatit Akademik Nr. 19, datë 15.01.2018
<b>3.17</b>	Vendim i Senatit Akademik Nr. 20, datë 15.01.2018
<b>3.18</b>	Miratimi i RVB-së
<b>3.19</b>	Veprimtari të Qendrës së Ekselencës
<b>3.20</b>	Vendim i Senatit Akademik Nr. 249, datë 17.07.2019
<b>3.21</b>	Organizimi i moduleve të trajnimit
<b>3.22</b>	Dokumente për rezultatet e pyetësorëve për studentët
<b>3.23</b>	Informacion për ecurinë e marrëveshjes me Universitetin e Napolit
<b>3.24</b>	Modeli i marrëveshjes për 1536 orë
<b>3.25</b>	Përqindja e programeve të studimit, që mbulojnë nga stafi akademik me kohë të plotë (Cikli I + II)
<b>3.26</b>	Përmbledhje e veprimtarive kërkimore në USH
<b>3.27</b>	Informimi i studentëve për mundësi studimi jashtë vendit
<b>3.28</b>	Të dhënat për mobilitetin e studentëve gjatë viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019
<b>3.29</b>	Raporti i rastit "KUADRI SCRUM"
<b>3.30</b>	Përmbledhje e pjesëmarrjes së studentëve në veprimtari jashtëkurrikulare
<b>3.31</b>	Përmbledhje e pjesëmarrjes së studentëve në veprimtari me natyrë sociale, kulturore dhe sportive
<b>4.1</b>	Marrëveshje me Sandhill College për praktikën profesionale
<b>4.2</b>	Marrëveshje me Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi"
<b>4.3</b>	Progres raport vjetor për praktikën profesionale
<b>4.4</b>	Raport i pedagogëve mbi ekspeditat e studentëve në terren
<b>4.5</b>	Procedura e plotë e ankimimit të studentëve
<b>4.6</b>	Shembuj të komisioneve të vlerësimit të studentëve
<b>4.7</b>	Model i analizës së punës kërkimore të një departamenti
<b>4.8</b>	Modele të vlerësimit të pedagogëve sipas përgjegjësisë
<b>4.9</b>	Model i planit të punës për vitin akademik pasardhës (2018-2019)
<b>4.10</b>	Ndryshimi i ngarkesës pas diskutimeve me studentët
<b>4.11</b>	Rregullore për Laboratorin e Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar
<b>4.12</b>	Plani i veprimtarive të Qendrës së Ekselencës për periudhën 2019-2020

4.13	Trajnim mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies
4.14	Rregullore të Zyrës së Ekselencës
4.15	Informacion për kualifikimin e pedagogëve
4.16	Raport për veprimtarinë kërkimore që Qendrave
4.17	Shembuj të marrëveshjeve me universitete të huaja
4.18	Pedagogë të huaj që japin mësim në USH
4.19	Leksione të hapura në USH
4.20	Lista e pedagogëve që kanë kryer studimet e doktoraturës jashtë vendit
4.21	Marrëveshje me organe kombëtare shkencore
4.22	Lista e pedagogëve që japin mësim jashtë vendit
4.23	Shembuj të botimeve të pedagogëve të USH-së
4.24	Shembuj të pjesëmarrjes së bordit editorial
4.25	Shembuj të botimeve të shkruara mbi arritjet e kërkimit shkencor
4.26	Shembuj të marrëveshjeve me institucione ekonomike
5.0	Për miratimin e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, Viti akademik 2019-2020.
5.1	Përmbledhje e studentëve nga trojet
5.2	Listë e studentëve të huaj
5.3	Studentë të huaj që kanë studiuar në USH
5.4	Modele të orareve të mbledhjeve me studentët
5.5	Miratim i lehtësirave financiare për disa kategori
5.6	Të dhënat e fakulteteve për numrin e studentëve sipas diplomës, studentëve të diplomuar gjatë tri viteve të fundit, dhe studentëve të huaj ose të transferuar
5.7	Paketa e provimeve përfundimtare, programet e Master-it
5.8	Rregullore "Për organizimin e zgjedhjeve të Këshillit Studentor, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"", Shkodër 2018
5.9	Listë e fituesve për çdo fakultet
5.10	Raport i zgjedhjeve studentore të para për Këshillin Studentor Institucional dhe Këshillat Studentorë në fakultete
5.11	Shpallja e fituesve dhe emrave të Drejtuesve të Këshillave Studentorë në Fakultete dhe Këshillit Institucional
5.12	Kërkesë e studentëve drejtuar rektorit të universitetit dhe kthim përgjigjeje
5.13	Raport i projektit të paraqitur nga studenti me iniciale A.P. "Meritokracia dhe ndikimi në motivimin e brendshëm të studentëve"
5.14	Gazeta "Nisma"
5.15	Revista <i>la Fievre du lendemain</i>
5.16	Evidenca të diplomave të veprimtarive sportive
5.17	Marrëveshje me Kryqin e Kuq
5.18	Punë vullnetare në bashkëpunim me <i>Eco mendje</i>
5.19	Informacione për studentët e diplomuar nga USH-ja dhe procesi i digjitalizimit ndër vite
5.20	Informacione për Alumnit në faqen zyrtare të internetit të universitetit
5.21	Panairi i punës 2018, organizuar nga Fakulteti Ekonomik
5.22	Statistika të ish-studentëve të USH-së, që aktualisht punojnë si staf akademik me kohë të plotë në këtë universitet
5.23	Ftesë në veprimtarinë "25 vjet FEUNISHK"

### C - Evidenca të vizitës në terren

Nr.	Përshkrimi
1	Numri i studentëve të regjistruar gjatë dy viteve të fundit në të gjitha programet e studimit.
2	Procesverbal i 2-3 mbledhjeve të Senatit Akademik, ku u trajtuan çështje, si: miratimi i rregulloreve, kurrikulave, financimit/veprimtarive të kërkimeve (për të kuptuar rolin dhe kompetencat e Senatit në orientimin dhe zgjidhjen e këtyre çështjeve)
3	Listë e programeve të reja, të hapura gjatë 2 viteve të fundit
4	Formularë të vlerësimit të studentëve për stafin akademik
5	Rregullore e Universitetit e përditësuar/e hartuar
6	Rregullore e përditësuar/e hartuar për “Gjetjen dhe Mbajtjen e një Pune”
7	Numri i stafit akademik dhe administrativ gjatë 3 viteve të fundit
8	Formular tip për identifikimin e zërave të ngarkesës së punës
9	Të ardhurat buxhetore të Universitetit me % nga buxheti i shtetit dhe % nga fitime të tjera të universitetit, për 3 vitet e fundit
10	Dosje e rekrutimit të fundit ( <i>Evidenca B.2.3</i> )
11	Statistika për treguesit e vlerësimit të stafit akademik
12	Rregullore/Manual i NJSBC-së
13	Ngarkesa e stafit akademik gjatë 2 viteve të fundit (%), për secilin program studimi
14	Të dhënat e zyrës së alumnit
15	Planimetri e Universitetit
16	Analizë e botimeve në revista që janë faktor ndikimi
17	Broshurë Informuese e Studentëve ( 2019-2020)
18	Vendim i Këshillit Akademik Nr. 324, datë 11.10.2019.
19	Certifikatë trajnimi

#### D– Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës në terren

Mbledhja Nr.	Dita 1: E hënë, 21 tetor 2019
Mbledhja 1	[M1]: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Rektorin.
Mbledhja 2	[M2]: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon anëtarë të Senatit Akademik (pa përfshirë Rektorin).
Mbledhja 3	[M3]: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon stafin e nivelit të lartë të Universitetit.
Mbledhja 4	[M4]: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të parë
Mbledhja 5	[M5]: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të dytë dhe të tretë
Mbledhja 6	[M6]: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup nga partnerët e jashtëm dhe alumnit.

Mbledhja Nr.	Dita 2: E martë, 22 tetor 2019
Mbledhja 7	[M7]: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Koordinatorin Institucional për të qartësuar çështje të ngritura.

<b>Mbledhja 8:</b> <b>Tur në universitet.</b>	<b>[M8]:</b> Tur në universitet. <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Sallë leksionesh e madhe</i></li> <li>• <i>Klasë e vogël</i></li> <li>• <i>Laborator i mësimdhënies</i></li> <li>• <i>Biblioteka e universitetit</i></li> <li>• <i>Biblioteka e fakultetit ose departamentit</i></li> <li>• <i>Godinat e teknologjisë së informacionit për studentët</i></li> <li>• <i>Godinat sociale dhe reflektuese për studentët</i></li> </ul>
<b>Mbledhja 9</b>	<b>[M9]:</b> Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Bordin e Administrimit dhe stafin e nivelit të lartë.
<b>Mbledhja 10</b>	<b>[M10]:</b> Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup nga stafi mësimdhënës.
<b>Mbledhja 11</b>	<b>[M11]:</b> Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup nga stafi kërkimor aktiv, nga çdo fakultet dhe njësi kërkimore qendrore.
<b>Mbledhja 12</b>	<b>[M12]:</b> Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Stafin Administrativ, përgjegjës për mbështetjen dhe shërbimet ndaj studentëve.
<b>Mbledhja 13</b>	<b>[M13]:</b> Grupi i vlerësimit jashtëm takon Grupin e Vetëvlerësimit.